



**Koalicioni i
Vëzhguesve
Vendorë
2013**

Contact: Tel/fax: + 355 4 2245078; Mob. + 355(0)692469393; (0)682039297;
E-mail: koalicioni2013@gmail.com;
Website: www.zgjedhje.al;

ZGJEDHJET PËR KUVENDIN E SHQIPËRISË

23 QERSHOR 2013

RAPORT I NDËRMJETËM I

2 Shtator 2012 – 14 Mars 2013

Tiranë, më 18 Mars 2013

Mbështetur financiarisht nga:

Fondacioni Kombëtar për Demokraci – SHBA
National Endowment for Democracy (NED) - USA

Mendimet dhe opinionet e shprehura në këtë raport nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht edhe ato të donatorit!

PËRMBAJTJA

	<i>faqe</i>
I. Hyrje	5
II. Përmbledhje	6
III. Konstatime	
A. Situata politike	8
B. Kuadri ligjor	8
C. Konstituimi i Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve	13
D. Administrimi i zgjedhjeve	14
D1. Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve	14
D2. Komisionet e Zonave të Administrimit Zgjedhor	22
D3. Institucione të tjera që përfshihen në ndërtimin e infrastrukturës zgjedhore	23
E. Listat dhe identifikimi i zgjedhësve	25
F. Fushata zgjedhore	28
G. Media	29
H. Pjesëmarrja e grave	30
K. Vëzhguesit	31
L. Ankesat dhe apelimet	32
IV. Rekomandime	35
SHTOJCË	
I. Letër e Hapur: Konstituimi i KQZ-së së Re - dt. 18/09/2012	40
II. Deklaratë: Mbledhja sa më parë e KQZ dhe dekretimi i datës së zgjedhjeve, të domosdoshme për përmbushjen e standardeve të procesit të ardhshëm zgjedhor- dt. 23/10/2012	43

III. Deklaratë: Standardet e procesit të ardhshëm zgjedhor në pikëpyetje nga moszbatimi dhe mosrespektimi i afateve të parashikuara në Kodin Zgjedhor – dt. 27/12/2012	44
IV. Deklaratë: Listat paraprake të zgjedhësve ende të pasakta e të papublikuara - dt. 09/01/2013	46
V. Letër e hapur: Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve të rishqyrtojë caktimin e mandateve të zonave zgjedhore – dt. 19/01/2013	48
VI. Deklaratë: Listat paraprake të zgjedhësve, mundësi të kufizuara për informimin e votuesve – dt. 10/02/2013	53
VII. Deklaratë: Mosnjoftimi i zgjedhësve, shkelje serioze e procesit të saktësimit të listave – dt. 27/02/2013	57

I. HYRJE

Koalicioni i Vëzhguesve Vendorë (KVV¹), është një aleancë organizatash jo-qeveritare dhe jo-politike thelbi i aktivitetit të cilave është zhvillimi i demokracisë në Shqipëri, veçanërisht vëzhgimi i proceseve elektorale, aktivitet të cilin e kanë kryer prej vitit 2005 (nën siglën KVV) duke e konsideruar vëzhgimin e zgjedhjeve si garancinë më të mirë për të siguruar lirinë dhe besueshmërinë e zgjedhjeve.

Filozofia dhe strategjia e KVV bazohet në tri shtylla: pavarësi, paanësi dhe objektivitet në respekt total të mosdiskriminimit².

Në kuadër të aksionit të vëzhgimit të Zgjedhjeve Parlamentare të Qershorit 2013, KVV drejtuar nga tri organizata Shoqata për Kulturë Demokratike, Shoqata KRIIK Albania dhe Shoqata për Gratë dhe Fëmijët, në bashkëpunim me së paku 31 organizata lokale³ (procesi i zgjerimit të KVV është në vazhdim) do të vëzhgohen të gjitha nivelet e administrimit dhe të gjitha fazat e përgatitjes, realizimit deri në publikimin e rezultateve finale të zgjedhjeve të ardhshme.

Pas vëzhgimit të Zgjedhjeve 2011 dhe ndjekjes në mënyrë aktive të procesit të reformës zgjedhore (Nëntor 2011 – Korrik 2012), KVV nisi angazhimin e vet për zgjedhjet e ardhshme parlamentare duke filluar monitorimin e periudhës parazgjedhore prej hyrjes në fuqi të amendimeve që iu bënë Kodit Zgjedhor.

Ky Raport përmbledh monitorimin e situatës parazgjedhore prej datës 2 Shtator 2012 të hyrjes në fuqi të amendimeve të Kodit Zgjedhor deri më datën 14 Mars 2013.

¹ Aksioni i parë i KVV ka qenë në vitin 2000 në mënyrë jo formale nën ombrellën e Shoqatës për Kulturë Demokratike. Në vitin 2003 me mbështetjen e OSBE-së grupimi u quajt Forumi i Vëzhguesve Vendorë duke përmbledhur 18 nga organizatat më të njohura në fushën e vëzhgimit të zgjedhjeve dhe të të drejtave të njeriut dhe prej vitit 2005 është quajtur Koalicioni i Vëzhguesve Vendorë duke patur kryesisht mbështetjen e Programit DGA të USAID, Ambasadës të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Tiranë dhe OSFA Soros. Koalicioni ka koordinuar aksionet më të gjera të vëzhguesve vendorë në vend në vitet 2005, 2007, 2009 dhe 2011 duke akredituar, trajnuar dhe shpërndarë rreth 2500 vëzhgues në qendra votimi në secilin prej rrethve të vëzhgimit në të gjithë territorin e vendit. Në këto aksione janë mbuluar rreth 45% e qendrave të votimit dhe 100% e vendeve të numërimit të votave në të 12 qarqet e Shqipërisë.

Nga një raund zgjedhor në tjetrin përbërja dhe metodologjia e vëzhgimit të adoptuar kanë ndryshuar në proporcion të drejtë me rritjen e profesionalizmit të vëzhguesve të angazhuar dhe Koalicionit si i tërë.

Për sa i përket metodologjisë, në çdo aksion të ndërmarrë nga Koalicioni nga viti në vit ai është përbërë nga organizata të ndryshme që ndajnë të njëjtat vlera për zgjedhje të lira e të ndershme, në respekt të standardeve demokratike. Prej 2005 në 2009 Koalicioni ka qenë i përbërë nga 6-8 organizata, të cilët në bashkëpunim miratuan një plan paraprak aksioni, nën drejtimin dhe koordinimin e Institutit Demokratik Kombëtar (NDI) (2005 dhe 2007) dhe Partners Albania (2009).

Duke synuar rritjen e kapaciteteve të aktorëve të vëzhgimit, ngritjen e një trupe vëzhguesish vendorë të përhershëm si dhe përfshirjen e një numri sa më të madh të mundshëm qytetarësh aktivë në këtë proces, tri organizatat drejtuese hartuan një strategji që synonte zgjerimin e Koalicionit me partnerë lokalë të cilat ndajnë të njëjtin vizion dhe vlera mbi mënyrën se si duhet të zhvillohen zgjedhjet dhe që nënshkruajnë Memorandumin e Mirëkuptimit të hartuar dhe miratuar bashkërisht.

Bazuar në filozofinë e mësipërme, Zgjedhjet Lokale të vitit 2011 u vëzhguan nga Koalicioni nën drejtimin e tri organizatave drejtuese dhe me bashkëpunimin e 15 organizatave lokale (18 në total).

Për herë të parë qysh prej krijimit të KVV-se, Zgjedhjet Vendorë të Majit 2011 u vëzhguan bazuar në një strategji e cila u konceptualizua, hartua, menaxhua dhe realizua duke përdorur vetëm kapacitetet e organizatave anëtare të Koalicionit. Me synimin e rritjes së integritetit dhe konsolidimit të mëtejshëm të aksionit të KVV, për zgjedhjet e vitit 2013 synohet zgjerimi i mëtejshëm i kësaj trupe me akoma më shumë organizata lokale.

² Gjatë çdo deklaratë dhe aksioni KVV respekton parimet e pavarësisë dhe paanësisë. Këto parime shkojnë krahas objektivitetit çka ndihmon në vlerësimin e drejtë të situatës dhe dhënien e një pamjeje të qartë të situatës dhe problematikave të vërejtura.

Diskriminimi është një çështje shumë e ndjeshme dhe KVV gjatë gjithë aksioneve të veta është përpjekur ta vërë në dukje dhe ta luftojë atë. Kjo do të thotë se pjesëmarrja është e ndërtuar në respekt të plotë të gjinisë, etnisë apo përkatësisë të tjera. Për sa u përket çështjeve gjinore, përveç ruajtjes së traditës për angazhimin e më shumë se 50% të aktivistëve gra dhe vajza, të gjitha materialet e publikuara prej KVV gjatë aksionit të vitit 2013 do të respektojnë dhe reflektojnë barazinë dhe balancën gjinore. Gjithashtu, funksionimi i brendshëm i zyrës do të ketë një qasje promjedisore.

³ Organizatat anëtare do të nënshkruajnë një *Memorandum Mirëkuptimi* ku bëhen të qarta rregullat dhe termat që duhet të respektojnë anëtarët e KVV gjatë gjithë kohëzgjatjes së aksionit, në respekt të Kodit të Etikës dhe Sjelljes së Mirë të Vëzhguesve Vendorë në Shqipëri.

II. PËRMBLEDHJE

- Më datën 3 Dhjetor 2012 Presidenti i Republikës shpalli datën 23 Qershor 2013 si datën e zhvillimit të Zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë.
- Zgjedhjet e 23 Qershorit zhvillohen me një kuadër ligjor të përmirësuar pas Reformës Elektorale të vitit 2012, përgjatë së cilës u prekën afro gjysma e neneve të Kodit Zgjedhor.
- Zgjedhjet Parlamentare do të mbahen në një situatë të polarizuar politikisht, në një situatë ekonomike të rënduar si dhe me një situatë kriminaliteti në rritje.
- Gati të gjitha partitë kryesore kanë nisur fushatën elektorale, duke shkelur hapur Kodin Zgjedhor. Nisja e parakohshme e fushatës ka ulur ritmin e funksionimit të institucioneve shtetërore.
- Zgjedhjet do të administrohen në nivel lokal nga 89 Komisione të Zonave të Administrimit Zgjedhor dhe 5505 Komisione të Qendrave të Votimit.
- Megjithëse kuadrit ligjor i janë bërë përmirësime sinjifikative, evidentohen një sërë vërejtjesh që lidhen me:
 - periudhën e shkurtër të pasjes në dispozicion për absorbimin më të mirë të ndryshimeve të Kodit;
 - hapat mbrapa që kanë të bëjnë me zbatimin e kuotave gjinore, në kundërshtim me konsensusin dhe frymën e shfaqur gjatë reformës elektorale.
- Përdorimi i teknologjive të reja, i Sistemit Elektronik të Verifikimit (SEV) dhe i Sistemit Elektronik të Numërimit (SEN), është një projekt pilot shumë i rëndësishëm, por deri tani për zbatimin e tyre janë shkelur të gjitha afatet e parashikuara.
- Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve u konstitua pas një procesi me shkelje procedurale dhe afatesh që i faturohen Kuvendit të Shqipërisë.
- Formula e zgjedhjes së KQZ-së është kontradiktore. Kryetari zgjidhet me konkurim të hapur publik dhe nga kandidatura jo-politike, ndërsa zgjedhja e 6 anëtarëve të tjerë bëhet sipas parimit të balancimit politik në KQZ.
- Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve ka treguar sjellje shpesh të orientuar sipas debatit politik të partive apo të përfaqësuesve të tyre.
- KQZ përgjatë kësaj periudhe ka shmangur përmbushjen e disa detyrimeve të vëna nga Kodi Zgjedhor, nuk ka respektuar afate të parashikuara në legjislacionin zgjedhor, janë vërejtur shkelje procedurale në funksionimin e tij, si dhe ka treguar performancë të ulët dhe mungesë profesionalizimi.
- Procesi i publikimit dhe saktësimit të listave të zgjedhësve vazhdon të mbetet problematik. Ka një numër të madh zgjedhësish pa adresë (ose me kodin 999) për të cilët nuk dihet si do të operohet.

- Një pjesë e Njësive të Qeverisjes Vendore kanë probleme me publikimin e ekstrakteve të përbërësve zgjedhore pasi zyrat e gjendjes civile kanë mungesë të bazës materiale.
- Dispozita e vetme ligjore që detyron shtetin shqiptar të njoftojë çdo qytetar për qënien apo jo në listë të tij, nuk u zbatua. Ky afat ishte data 3 Mars 2013.
- Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile në kundërshtim me ligjin, gjeneroi modelin e njoftimit pranë zyrave të gjendjes civile vetëm pas datës 3 mars 2013.
- Ministria e Brendshme, në kundërshtim me ligjin, nuk i lëvroi Njësive të Qeverisjes Vendore fondin e nevojshëm për njoftimin e zgjedhësve.
- Fushata zgjedhore ka nisur nga partitë kryesore politike në kundërshtim me Kodin Zgjedhor i cili sanksionon se fushata elektorale fillon me datën 23 maj 2013.
- Zyrtarë të lartë të shtetit shfrytëzojnë për fushata elektorale partiake aktivitete të organizuara në kuadrin e institucioneve shtetërore.
- Amendimet në nenet që kanë të bëjnë me kuotën gjinore, të bëra pa kujdes në teknikën legjislativë të ndjekur, në vend që të sillnin më shumë zbatim të kuotave të barazisë gjinore, hoqën edhe ato pak arritje të siguruara deri në atë moment.
- Procesi zgjedhor deri në këtë moment, ka krijuar dy precedentë të fortë në dhënien e drejtësisë në çështje zgjedhore. Dy kazuse ligjore, ku dy partitë kryesore Partia Socialiste dhe Partia Demokratike investojnë Kolegjin Zgjedhor dhe Gjykatën Kushtetuese.
- Vendimi i Kolegjit Zgjedhor për caktimin e ZAZ-ve, konsiderohet një vendim i marrë në kundërshtim me Kodin Zgjedhor dhe procedura të tjera ligjore.

III. KONSTATIME

A. SITUATA POLITIKE

Zgjedhjet Parlamentare të 23 Qershorit 2013 po mbahen në klimë politike të polarizuar, e cila ka filluar që pas rezultatit të kontestuar të Bashkisë së Tiranës, dhe ka vazhduar më pas me shqetësimin permanent të opozitës për dominimin e të gjitha institucioneve të pavaruara nga mazhoranca, sic ishte zgjedhja e Presidentit të Republikës, Prokurorit të Përgjithshëm, Këshillit të Lartë të Drejtësisë, etj.

Midis partive politike e veçanërisht midis dy partive të mëdha vazhdon të ketë një mosbesim të thellë politik, i cili tashmë iu është faturuar edhe institucioneve të pavarura.

Vendimet e gjykatës në lidhje me ngjarjen e Gërdecit apo ngjarjet e 21 Janarit e kanë thelluar akoma më shumë hendekun midis forcave politike si dhe kanë shtuar pikëpyetje tek qytetarët për forcën e zbatimit të ligjit dhe të funksionimit të institucioneve të pavarura.

Në këtë terren nisi edhe Reforma Zgjedhore që prej Nëntorit 2011 deri në Korrik 2012. Në fillim të saj, për shkak të gjetjes së vullnetit të përbashkët midis PD dhe PS, reforma eci me ritme të shpejta, ndërkohë që në fund të saj, u rikthyen mosmarrëveshjet dhe konflikti politik midis dy partive.

Për përmbylljen e reformës zgjedhore u deshën mesazhe të forta politike nga institucionet partnere ndërkombëtare, në sajë të të cilave u bë i mundur finalizimi i Reformës në Korrik 2012.

Kërkesës së faktorit ndërkombëtar për miratimin e tre ligjeve të mbetura, për të cilat kërkohet shumicë e cilësuar prej 84 votash, opozita i është përgjigjur me kushtin për të zgjidhur ngërçin e qarkut të Fierit, i cili vazhdon të mbetet i pa zgjidhur që pas zgjedhjeve vendore të Majit 2011, duke bllokuar njëkohësisht çdo mundësi bashkëpunimi midis dy forcave më të mëdha politike.

Kjo situatë politike shoqërohet edhe me një gjendje të rënduar ekonomike në tërësi për shkak të krizës financiare që po kalon vendi.

Madje, kohët e fundit është vënë re një rritje e shkallës së kriminalitetit, duke shkaktuar viktima edhe në radhët e funksionarëve të lartë të Policisë së Shtetit.

Për më tepër, nisja e fushatës elektorale ka zhvendosur vëmendjen në zgjedhjet e ardhshme, duke ulur ritmin e funksionimit të institucioneve shtetërore.

B. KUADRI LIGJOR

Legjislacioni zgjedhor ka në themelin e tij Kushtetutën e Shqipërisë, e cila u amendua me ligjin Nr. 9904, datë 21.4.2008. Në kushtetutë aktualisht gjenden fare pak dispozita me objekt zgjedhor, por edhe këto, janë deklamative dhe jo teknike.⁴

⁴ Neni 1, pika 3, Kushtetuta e Shqipërisë, "Qeverisja bazohet në një sistem zgjedhjesh të lira, të barabarta, të përgjithshme e periodike."

Kodi Zgjedhor i miratuar më 29.12.2008 është bërë objekt amendimi nëpërmjet ligjit nr. 74/2012, datë 19.07.2012, i cili finalizoi procesin e reformës elektorale prej më shumë se 8 muajsh.

Ndër ndryshimet më të rëndësishme të Kodit Zgjedhor përmendim:

- a. Në Qarkun e Tiranës në këto zgjedhje, përgjatë procesit të votimit do të aplikohet teknologjia e verifikimit elektronik të votuesit. (SEV - Sistemi Elektronik i Verifikimit)
Me qëllim verifikimin dhe regjistrimin e pjesëmarrjes së zgjedhësve në Qarkun e Tiranës në ditën e votimit ngrihet sistemi elektronik i integruar për verifikimin dhe regjistrimin e pjesëmarrjes së zgjedhësve në datën e votimit.
- b. Në Qarkun e Fierit në këto zgjedhje do aplikohet teknologjia e numërimit elektronik të votave (SEN – Sistemi Elektronik i Numërimit)
Sistemi Elektronik i Numërimit numëron dhe vlerëson fletët e votimit, dhe llogarit në mënyrë automatike rezultatin e zgjedhjeve në Qarkun e Fierit.
- c. Rregullorja e KQZ-zë miratohet brenda 60 ditëve nga mbledhja e parë e KQZ-së.
Dukë patur parasysh mosmiratimin e rregullores as në zgjedhjet parlamentare të 2009 dhe as në ato Lokale të 2011, legjislatori i vendosi një kërkesë në kohë KQZ-së për ta miratuar rregulloren e saj.
- d. Përzgjedhja e Kryetares KQZ-së nëpërmjet konkurimit të hapur publik
Kryetari i ri KQZ-së zgjidhet me konkurim të hapur publik. Një formë e re përzgjedhjeje, duke e bërë kështu një figurë më me integritet dhe jashtë direktivës politike.
- e. Pakicës së mendimit në KQZ (së paku dy komisionerëve), i jepet e drejta të investojnë automatikisht KQZ-në në tema jashtë rendit të ditës
Për t'i dhënë mundësi artikulimi çdo mendimi, qoftë edhe në minorancë, legjislatori parashikon që së paku dy anëtarë të shtrojnë në rendin e ditës çfarëdoqë tëme.
- f. Një në tre emrat e parë dhe 30 % e listën shumëmemërore të kandidatëve duhet t'i përkasë secilës gjini.
Në kuadër të zbatimit të kuotave gjinore në listën shumëmemërore të kandidatëve, ndryshe nga Kodi i vjetër, jo vetëm që tridhjetë përqind e emrave i përkasin secilës gjini, por një është medoemos në tre vendet e para.

Veçmas Kushtetutës dhe Kodit zgjedhor, korpusi legjislativ përbëhet prej Kodit Penal, Kodit të Proçedurës Civile, Kodit të Proçedurës Administrative, Rregullores së Brendshme të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, etj.

Problematikat e vërejtura:

1. Përgatitja e SEV-it dhe SEN-it

Prej gushtit të vitit 2012, kur hyri në fuqi amendimi i Kodit Zgjedhor, deri në qershorin e vitit 2013, kur do mbahen zgjedhjet, është një distancë prej 10 muajsh.

Një periudhë kjo që nuk të bind teknisht, kur mendohet edhe thellësia në ndërhyrjen në Kodin Zgjedhor⁵ dhe risitë që sillen në këto zgjedhje.

Sistemi i votimit elektronik në Qarkun e Tiranës dhe sistemi elektronik i numërimit në Fier, si projekte pilot, përbëjnë një hap shumë të rëndësishëm dhe njëkohësisht është një provë për mundësinë e përdorimit të teknologjisë në terrenin shqiptar.

Në dy qarqe ku gjenden më shumë se një e treta e numrit të votuesve në rang vendi, do sillen një novacion madhor teknologjik edhe legjislativ në një kohë prej 10 muajsh.

⁵ Kodi Zgjedhor është amenduar në 99 nene nga 186 nene që ka ai, pra më shumë se gjysma e dispozitave.

Sjellim në vëmendje mbi këtë çështje “Kodin e Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore” i hartuar prej Komisionit të Venecias, organ këshillues ky i Këshillit të Europës.

Në këtë Kod afirmohen pesë shtylla kryesore të një procesi të rregullt zgjedhor, ku ndër to është edhe qendrueshmërinë e të drejtës zgjedhore.

Mbi këtë çështje do të gjejmë këtë vlerësim: “*Elementët themelore të së drejtës zgjedhore, dhe, në veçanti, të sistemit zgjedhor, përbërjes së komisioneve elektorale, dhe hartimit të kufijve të zonave zgjedhore, nuk duhet të ndryshohen më pak se një vit përpara zgjedhjeve, ose duhet të shkruhen në kushtetutë ose në një dokument ligjor të një niveli më të lartë se legjislacioni i zakonshëm.*”⁶

Ky parim i afirmuar në këtë Kod është përdorur si bazë ligjore prej Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut në procesin Ekoglasnost kundër Bullgarisë. Në rastin në fjalë, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në Bullgari, dy muaj para datës së zgjedhjeve shton në dokumentacionin për regjistrimin e subjekteve zgjedhore tre dokumenta (një vendim nga Gjykata e Auditit, pagimin e një shume monetare dhe një listë me firmat e 5000 votuesve). Partia Ekoglasnost, që ndër ato parti, që nuk pranoi t’i dorëzonte këto tre dokumenta në regjistrim me argumentet që shumica financiare ishte e lartë dhe dhënia e firmave të 5000 votuesve përbente shkelje kushtetuese. Si rezultat, KQZ-ja Bullgare e la jashtë zgjedhjeve këtë parti për shkak të dokumentacionit të paplotësuar.

Kjo çështje do mbërrinte në dyert e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut.

*Kjo gjykatë duke përdorur si bazë ligjore pikërisht Kodin e miratuar prej Komisionit të Venecias do kritikonte vendimin e marrë prej autoritetit bullgar në respektimin e afateve në ndryshimet që sillte.*⁷

Përballë një precedenti të tillë dhe duke e qasur me rastin në të cilin gjendemi, aktorët politikë dhe legjislatori duhet të jenë të vëmendshëm për respektimin e afatit njëvjeçar përpara ditës së zgjedhjeve, për të miratuar ndryshime në legjislacionin zgjedhor.

2. Handikape të Kodit Zgjedhor

a. Kodi Zgjedhor ndonëse nuk emërtohet si **kod proçedural**, përmbajtja e tij më së shumti është e tillë.

Mosbërja e qartë e natyrës së kodit, sjell ekuivoke jo të vogla, bën të vështirë interpretimin si dhe nuk e bën shumë efikase punën e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Me një Kod Proçedural Zgjedhor të pastër, do të shmangej përsëritja ciklike e debateve teknike në tryezën e KQZ-së, që nuk kthehen në një traditë pozitive.

Sanksionimi njëherë e mirë i tërë teknikaliteteve në një Kod Proçedural do i ngarkonte KQZ-së një status më ekzekutiv duke ia zvogëluar barrën legjislative. Moskryerja e interpretimeve nga KQZ-ja do të minimizonte ndjeshëm edhe bërjen pjesë të saj në diskutimet politike.

b. Amendimet e fundit të kryera në Kodin Zgjedhor, deri në këtë pikë të procesit, kanë sjellë problemin më të madh, përse i përket neneve 67⁸ dhe 175 mbi **kuotat e barazisë gjinore**.

⁶ Artikulli 2 gërma a), “Kodi i Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore”, Komisioni i Venecias, 2002

⁷ Gjykata Europiane të Drejtave të Njeriut, Ekoglasnost v. Bulgaria, 06.11.2012, “*Periudha një vjetore e mbrojtur prej Komisionit të Venecias për futjen e amendamenteve përmbajtësore në ligjin elektorale nuk vihet re. Amendamentet në fjalë kanë hyrë në fuqi dy muaj para datës së zgjedhjeve dhe një muaj para afatit të fundëm të regjistrimit të partive në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.*”

Në neni 67 parashikohen kërkesat që duhen të plotësojnë listat shumëmemërore të kandidatëve dhe në pikën e fundit evokohet neni 175 për të gjetur sanksionet për mos zbatimin e kërkesave të sipërpërmendura.

Ndërkohë neni 175 ka vetëm një dispozitë mbi sanksionet për mosplotësimin e kuotave të barazisë gjinore. Në nenin e parë parashikohen sanksionet financiare⁹ dhe në të dytin parashikohet sanksioni plotësues për zëvendësimin që mund të kryejë vetë KQZ-ja në listat shumëmemërore të paraqitura, për realizimin e kuotave¹⁰.

Në këtë situatë lindin dy pikëpyetje:

Së pari, a parashikon kodi masa për mosrealizimin e kërkesave të tjera që përmenden në 5 pikat e tjera të nenit 67, përveç kuotave gjinore?

Së dyti, nëse lista shumëmemërore nuk ka mjaftueshëm emra për të kryer zëvendësimin në përqindjen gjinore që kërkon ligji, si do veprojnë KQZ-ja?

Në udhëzimin¹¹ e miratuar prej KQZ-së, për mosplotësim të kërkesave të nenit 67, parashikohet refuzimi prej administratës veçmas kuotës gjinore, për të cilën parashikohet sanksion financiar.

Amendimet në nenet që kanë të bëjnë me kuotën gjinore, të bëra pa kujdes në teknikën legjislativë të ndjekur, në vend që të sillnin më shumë zbatim të kuotave të barazisë gjinore, hoqën edhe ato pak arritje të siguruara deri në atë moment.

c. **Kryetari i KQZ-së**, sipas nenit 15, pika 2¹² emërohet pas një thirrje të hapur publike për konkurim. Filtrimi i mëpasshëm është teknik dhe që përpiqet të sigurojë një pastërti politike, duke u përpjekur të japë një figurë me integritet të lartë.

Nga ana tjetër, **zëvendëskryetari i KQZ-së** zgjidhet sipas pëlqimit politik të partisë më të madhe opozitare.¹³

Kjo formulë teorikisht vendos në drejtimin e KQZ-së dy personalitete të ndryshme, njërin si propozim të partisë politike dhe tjetrin që nuk vjen prej një propozimi politik.

Për më tepër, Kodi parashikon se nënkryetari është i autorizuar nga ligji të kundërfirmosi çdo akt të Kryetarit, që ka të bëjë me administrimin e brendshëm në lidhje me administratën e KQZ-së. Madje, parashikohet se akti nuk ka asnjë fuqi, në qoftë se nuk është i bashkëfirmosur edhe nga kryetari dhe nga zëvendëskryetari.

⁸ Neni 67, pika 6 “Për çdo zonë zgjedhore, të paktën tridhjetë për qind e listës shumëmemërore dhe një në tre emrat e parë të listës shumëmemërore duhet t’i përkasë secilës gjini. Subjekti paraqitës i listës deklaron vendet, sipas kuotës gjinore, me qëllim zbatimin e përjashtimit, sipas pikës 2 të nenit 164 të këtij Kodi.”

⁹ Neni 175, pika 1 “Mospërmbushja nga ana e subjektit zgjedhor e detyrimeve të parashikuara në pikën 6 të nenit 67 të këtij Kodi, në lidhje me përbërjen e listës, dënohet nga KQZ-ja me gjobë 1 000 000 lekë në rastin e zgjedhjeve për Kuvendin dhe 50 000 lekë në rastin e zgjedhjeve për organet e pushtetit vendor, si dhe sanksionin plotësues, sipas pikës 2 të këtij neni.”

¹⁰ Neni 175, pika 2 “Kur ndaj një subjekti zgjedhor është konstatuar shkelja, KQZ-ja zbaton si sanksion plotësues zëvendësimin e çdo vakance në listën e subjektit, në zonën ku është konstatuar shkelja, me kandidatët vijues në listë nga gjinia më pak e përfaqësuar deri në plotësimin e kuotës gjinore. Në rast se KQZ-ja vendos aplikimin e këtij sanksioni, përjashtimi i pikës 2 të nenit 164 nuk zbatohet dhe vakanca plotësohet sipas kësaj pike.”

¹¹ Udhëzimi Nr. 2, datë 29.01.2013, “Për caktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit dhe afatet për publikimin e listave të kandidatëve”.

¹² Neni 15, pika 2 “Jo më vonë se 30 ditë para datës së mbarimit të mandatit të Kryetarit të KQZ-së, Kuvendi i Shqipërisë publikon shpalljen për vendin vakant të Kryetarit të KQZ-së. Çdo shtetas që plotëson kushtet e nenit 12 të këtij Kodi mund të paraqitet si kandidat për Kryetar të KQZ-së. Kërkesa paraqitet e shoqëruar me dokumentacionin përkatës që provon përmbushjen e kritereve ligjore për anëtar të KQZ-së.”

¹³ Neni 16, pika 1 “KQZ-ja zgjedh si Zëvendëskryetar një nga anëtarët e KQZ-së, të zgjedhur mbi bazën e propozimit të partisë më të madhe të opozitës parlamentare, sipas pikës 1 shkronja “a” të nenit 14 të këtij Kodi.”

Pavarësisht frymës që përcakton ligji, praktikisht konstatohet se tensioni politik është shpesh i pranishëm në funksionimin e KQZ-së, dhe sidomos kjo vërehet midis dy drejtuesve të KQZ, Kryetarit dhe Zëvendëskryetarit, të cilët shpesh qëndrojnë në linjë me dy forcat më të mëdha politike.

d. Shqetësime të vërejtura në lidhje me teknikën legjislative të përdorur në hartimin e Kodit Zgjedhor.

Në Kodin Zgjedhor vërehen dy problematika përsa i përket terminologjinë së përdorur, konkretisht **terminologjisë normative dhe asaj kohore**.

Së pari, ka të bëjë me përdorimin në Kod të termit “*si rregull*”. Një term i përdorur 15 herë, por që krijon konfuzion në zbatim. Administrata, sipas pohimeve që ka bërë në lidhje me këtë çështje, një term të tillë e lexon si të ishte udhëzues dhe jo detyrues.

Për të patur një efikasitet dhe zbatueshmëri më të lartë të KQZ-së dhe administratës së saj, në të ardhmen do të duhet të bëhet një sqarim në lidhje me këtë pikë.

Ndërkohë, edhe vetë KQZ-ja në udhëzimet dhe vendimet që merr, duhet të përpiket t’i lexojë dispozitat që përdorin termin “*si rregull*” si dispozita detyruese.

Së dyti, terminologjia kohore që përdoret në lidhje me afatet në Kodin Zgjedhor shpesh krijon paqartësi. Duke u shoqëruar edhe me mungesën e vullnetit të mirë krijohen probleme serioze në mbarëvajtjen e punës, respektimin apo llogaritjen e afateve për proceset dhe procedurat e parashikuara në Kodin Zgjedhor.

Në Kod, në disa raste përdoren afatet me ditë dhe në disa të tjera përdoren afatet me muaj. Është e nevojshme të bëhet një unifikim i përcaktimit të afateve, për të mos shkaktuar problematika në përllogaritje.

Kjo duhet të kihet parasysh nga ligjvënësi në të ardhmen, por edhe nga KQZ-ja sa të mundet në vendimet dhe udhëzimet që merr.

3. Rregullorja e Brendshme të KQZ-së

Vendosja e afatit për miratimin e “*Rregullores së Organizimit dhe Funksionimit të KQZ-së*” në amendimet e bëra, kishte për qëllim vendosjen e kufirit kohë për t’a detyruar KQZ-në që të gjente unanimitetin.¹⁴

Edhe përballë këtij detyrimi të ri KQZ-ja nuk ka marrë ende vendim.

Kodi Zgjedhor e parashikon në nenin 184, pika 2, që jo më vonë se data 26.12.2012 KQZ-ja duhej të miratonte Rregulloren. Në mbledhjen e 28.12.2012, në rendin e ditës ishte miratimi i Rregullores, por kjo pikë u shty. Mungesa e një Rregulloreje dhe vonesa tejet e madhe prej afatit ligjor e ka vështirësuar punën e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Një projekt për miratimin e rregullores, i përgatitur edhe me ndihmën e një eksperti nga Komisioni i Venecias, u fut për miratim në rendin e ditës në mbledhjen e datës 13.03.2013. Shqyrtimi i saj u shty pas debateve në lidhje me nevojën e miratimit të një rregulloreje të re në kushtet e mungesës së një rregulloreje në fuqi, apo të miratimit të ndryshimeve mbi bazën e një rregulloreje ekzistuese që konsiderohet ende në fuqi.

¹⁴ Neni 184, pika 2 “*Jo më vonë se 60 ditë nga mbledhja e parë, KQZ-ja e zgjedhur pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, miraton Rregulloren e KQZ-së, e cila përfshin edhe marrëdhëniet e anëtarëve të saj me administratën e KQZ-së.*”

Akti "Për Organizimin dhe funksionimin e KQZ-së" i miratuar me Vendimin nr. 26, datë 3 Mars 2005, të cilës administrata dhe disa komisionerë i referohen si rregullore në fuqi, ka efekt nul, pasi ky akt ka si bazë të vetën Kodin Zgjedhor të 2003, tashmë të shfuqizuar.

C. KONSTITUIMI I KOMISIONIT QËNDROR TË ZGJEDHJEVE

Në bazë të Kodit Zgjedhor për herë të parë parashikohet një konkurrim i hapur për vendin e kryetarit të KQZ-së, për të cilin përjashtohen partitë politike të japin kandidaturat e tyre.

Ndërkohë për 6 anëtarët e KQZ-së Kodi lë formulën e mëparshme të zgjedhjes së tyre e cila bazohej në balancimin politik të komisionit.

Sipas amendimeve të bëra, nga partitë politike parlamentare në lidhje me propozimet e tyre për gjashtë anëtarët e KQZ-së, deri më datën 15 Shtator 2012¹⁵, nuk ishte ndërmarrë asnjë hap institucional, duke shkelur kështu këtë afat ligjor të parashikuar në Kodin Zgjedhor, nga vetë partitë.

Kodi parashikon se kandidaturat i ofrohen Komisionit të Ligjeve në Kuvendin e Shqipërisë të dubluara, pra për çdo vakancë i propozohen dy kandidatura.

Në rastin e dy kandidaturave të paraqitura nga PD dhe PS, në frymën e Kodit Kryetarët respektivë të Grupeve Parlamentare zgjedhin ndër 8 kandidatët e ofruar 4 prej tyre të cilët i kalojnë në seancë plenare Kuvendit për miratim.

PD dhe PS i ofruan Komisionit Parlamentar kandidatura të vetme, të cilat në frymën e Kodit nuk mund të quhen më propozime, por janë emërime nga këto dy parti.

Ndërkohë PBDNJ dhe LSI i paraqitën kandidaturat e tyre me kandidatura alternative sikundër e parashikon Kodi Zgjedhor.

Për kandidaturën e kryetarit të KQZ-së u paraqitën 18 kandidatura.

Koalicioni i sugjeroi Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, si organi që përzgjedh dhe i propozon Kuvendit kandidaturat finale për Kryetar të KQZ-së, që në frymën dhe në zbatim të ligjit të miratonte dhe të bënte publike paraprakisht kriteret mbi të cilat do të organizohen seancat publike dhe mbi të cilat do të bëhej vlerësimi i kandidatëve, si vizioni, eksperiencia, apo çështje të tjera që lidhen direkt apo indirekt me administrimin e një procesi zgjedhor konform standarteve dhe aspiratave demokratike të shoqërisë dhe shtetit shqiptar.

Procesi i përzgjedhjes së kryetarit të KQZ-së në fund rezultoi një proces në bllok dhe me orientim të dukshëm politik.

Pas plotësimit të kandidaturave dhe përzgjedhjes së anëtarëve të rinj të KQZ-së, brenda 48 orëve duhet të ishte bërë betimi në Kuvendin e Shqipërisë, proces i cili u bë pas një jave më datën 18 Tetor 2012.

¹⁵ Ligji nr. 74/2012 datë 19.07.2012 (i dekretuar nga Presidenti i Republikës më datën 16.08.2012) "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10 019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë": Neni 181 "Zgjedhja e anëtarëve të KQZ-së", pika 1 "Kuvendi, 30 ditë nga data e shpalljes së këtij ligji, zgjedh anëtarët e KQZ-së, sipas neneve 14 dhe 15 të këtij Kodi".

D. ADMINISTRIMI I ZGJEDHJEVE

Legjislacioni Zgjedhor parashikon se Zgjedhjet për Kuvendin administrohen nga komisionet zgjedhore të tre niveleve – Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve (KQZ), 89 Komisione Zonale të Administrimit Zgjedhor (KZAZ) dhe 5505 Komisione të Qendrave të Votimit (KQV). Numërimi i votave do të bëhet në 89 Vende të Numërimit të Votave (VNV), një për çdo Zonë të Administrimit Zgjedhor (ZAZ), prej Grupeve të Numërimit të Votave (GNV).

Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve, Komisioni Zonal i Administrimit Zgjedhor si dhe Komisionet e Qendrave të Votimit përbëhen nga 7 anëtarë.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organi më i lartë shtetëror i përhershëm, i ngarkuar për administrimin e zgjedhjeve¹⁶.

Trupa e re e KQZ-së, e nisi punën me datë 26.10.2012. Ndërsa KZAZ-të priten të ngrihen me vendim të KQZ-së deri me 25.03.2012 dhe KQV-të duhet të emërohen prej KZAZ-ve deri me date 03.06.2013.

D1. KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) drejton dhe kontrollon kolegjisht, nëpërmjet çdo anëtari ose strukturave të tij, procesin parazgjedhor dhe atë zgjedhor. Ai përgatit infrastrukturën njerëzore dhe financiare për realizimin e procesit të votimit dhe të numërimit, si dhe në zbatim të Kodit Zgjedhor harton dhe miraton akte për realizimin e procesit zgjedhor.

KQZ ende nuk ka një rregullore të brendshme për funksionimin dhe organizimin e saj, megjithëse ligjvënësi në amendimet e bëra në Korrik 2012 vuri kusht miratimin e kësaj rregulloreje brenda datës 26 Dhjetor 2012.

Mungesa e kësaj rregulloreje ka sjellë jo pak probleme në funksionimin dhe performancën e Komisionit, duke ndikuar shpesh në funksionalitetin dhe rendimentin e punës së tij.

Politizimi pa shkak i çështjeve thellësisht teknike si ndarja e ZAZ-ve apo e mandateve për çdo zonë zgjedhore, solli heqjen dorë të KQZ-së nga detyrimi i saj primar për të marrë dy nga vendimet më të rëndësishme të përgatitjes së procesit të ardhshëm zgjedhor.

Ndër problematikat e vërejtura përgjatë veprimtarisë së deritanishme të KQZ përmendim:

1. Mosrespektimi i afateve

KQZ si organi më i lartë i administrimit të zgjedhjeve duhet të ushtrojë autoritetin dhe kompetencat e dhëna nga ligji për të detyruar të gjithë hallkat në varësi apo institucionet e tjera të ngarkuara nga ligji për përgatitjen e infrastrukturës zgjedhore, që të zbatojnë me korrektësi afatet ligjore të parashikuara.

Vetë Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve, në mjaft raste nuk ka respektuar afatet ligjore për vendimmarrje të parashikuara në Kodin Zgjedhor si dhe në Kalendarin e punës të miratuar me vendim nga vetë KQZ.

¹⁶ Neni 2, pika 7 “KQZ është Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, i cili është organi më i lartë shtetëror i përhershëm, i ngarkuar për administrimin e zgjedhjeve, në përputhje me rregullat e përcaktuara në këtë Kod.”

a. *Mosmiratimi i Rregullores së Brendshme*¹⁷

Kodi Zgjedhor në nenin 184 pika 2 parashikon që jo më vonë se data 26.12.2012, Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve duhet të kishte miratuar Rregulloren e KQZ-së, e cila përfshin edhe marrëdhëniet e anëtarëve të saj me administratën e KQZ-së.

KQZ e futi në rendin e ditës në mbledhjen e datës 28.12.2012, por me kërkesë të partive politike dhe aprovim nga të gjithë anëtarët e komisionit, kjo pikë u shty për t'u trajtuar në mbledhjen e radhës. Kjo rregullore ende nuk është miratuar.

(Rregullorja filloi të merret në shqyrtim në mbledhjen e datës 13 Mars 2013, pas marrjes së opinionit edhe nga një ekspert i Komisionit të Venecias, por shqyrtimi i saj sërish u shty për në mbledhjen e radhës së datës 15 Mars 2013).

b. *Mosndarja e Zonave të Administrimit Zgjedhor*¹⁸

Kodi Zgjedhor parashikon që jo më vonë se data 7 Dhjetor 2012, Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve duhet të kishte kryer ndarjen e Zonave të Administrimit Zgjedhor.

KQZ-ja jo vetëm që u tregua e pazonja të plotësonte kriterin kohë të këtij detyrimi, por u dorëhoq fare prej tij me argumentimin se: *“mungesa e numrit të kërkuar ligjërisht të votave “pro” sjell si pasojë, që projekt-akti i paraqitur për ngritjen e 89 ZAZ-ve të rrëzohet.”*¹⁹

c. *Moscaktimi i numrit të mandateve për çdo zonë zgjedhore*²⁰

Kodi Zgjedhor parashikon se jo më vonë se data 24 Nëntor 2012, Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve duhet të kishte kryer caktimin e mandateve për çdo zonë zgjedhore. KQZ-ja jo vetëm që nuk arriti të zbatonte afatin e përcaktuar në Kod, por hoqi dorë fare me argumentimin se: *“mungesa e numrit të kërkuar ligjërisht të votave “pro” sjell si pasojë, që projekt-akti i paraqitur “Për caktimin e numrit të mandateve për çdo zonë zgjedhore të zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë të vitit 2013”, të mos miratohet.”*²¹

d. *Mosrealizimi i teknologjisë së re informative, SEV dhe SEN*²²

Pavarësisht se teknologjitë e reja (respektivisht Sistemi Elektronik i Verifikimit dhe Sistemi Elektronik i Numërimit) që do të përdoren janë projekte pilot, ato janë mjaft të rëndësishme pasi suksesi ose jo i tyre do të kushtëzojë mundësinë e përdorimit të tyre në të gjithë vendin në të ardhmen.

¹⁷ Neni 184, pika 2 *“Jo më vonë se 60 ditë nga mbledhja e parë, KQZ-ja e zgjedhur pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, miraton Rregulloren e KQZ-së, e cila përfshin edhe marrëdhëniet e anëtarëve të saj me administratën e KQZ-së.”*

¹⁸ Neni 27, pika 5 *“Zonat e Administrimit Zgjedhor miratohen nga KQZ-ja jo më vonë se 9 muaj para përfundimit të mandatit të Kuvendit, mbi bazën e numrit të shtetasve me të drejtë vote në datën e fundit të periudhës zgjedhore për caktimin e zgjedhjeve, sipas të dhënave të Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile.”*

¹⁹ Vendimi Nr. 20, datë 21.12.2012, *“Për mosmiratimin e ndarjes se re të zonave të administrimit zgjedhor për Zgjedhjet për kuvendin 2013”.*

²⁰ Neni 76, pika 2 *“Jo më vonë se 15 ditë nga marrja e të dhënave, KQZ-ja kryen llogaritjen për caktimin e mandateve për çdo zonë zgjedhore, sipas kriterëve dhe procedurave të përcaktuara në nenin 75 të këtij Kodi dhe ia dërgon menjëherë Kuvendit. Kuvendi, me procedurë të përshpejtuar, miraton me vendim ndarjen e mandateve.”*

²¹ Vendimi Nr. 15, datë 23.11.2012, *“Për caktimin e numrit të mandateve për çdo zonë zgjedhore të zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë të vitit 2013”.* (Për më tepër, shih *“Letrën e Hapur”* të KVV-së, datë 19.01.2013 tek aneksi 5 i këtij raporti ose tek: <http://www.zgjedhje.al/index.php?idart=37&gj=sh>)

²² Neni 179/1, pika 6 *“Procedurat për blerjen e shërbimit dhe/ose pajisjeve të SEN-it dhe SEV-it kryhen me operatorë të mirënjohur që ofrojnë teknologji të provuara me sukses në fushat respektive. Procedurat e prokurimit, si rregull, duhet të përfundojnë jo më vonë se 6 muaj përpara zgjedhjeve për Kuvendin të vitit 2013.”*

Në lidhje me këto dy procese janë shkelur dhe tejkaluar të gjitha afatet e parashikuara. Ndërkohë shqetësues mbetet fakti i mungesës së transparencës në lidhje me këtë proces. Ky fakt është vënë në dukje disa herë edhe nga përfaqësuesi i Partisë Socialiste, sipas të cilit edhe pse ka bërë kërkesa zyrtare pranë sekretarisë së KQZ-së, ende nuk ka marrë sqarime zyrtare.

2. Shqetësime mbi vendimet e marra

Në vendimmarrjen e saj përgjatë kësaj periudhe, KQZ është treguar e pakujdesshme në miratimin e dy akteve të cilat krijojnë jo pak shqetësim me përmbajtjen dhe zbatimin e tyre.

a. Udhëzimi Nr. 2, datë 29.01.2013, “Për caktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidatimit dhe afatet për publikimin e listave të kandidatëve”.

Sipas nenit 10 të këtij vendimi me titull “Kthimi për plotësim dhe miratimi i dokumentacionit zgjedhor”, mosplotësimi i kuotave të barazive gjinore në listat shumë emërore të kandidatëve²³ nuk përbën arsye për refuzimin e tyre prej Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

E vetmja masë që mund të merret ndaj subjekteve që do të dorëzojnë lista shumë emërore të kandidatëve pa plotësuar kriterin gjinor, janë sanksionet financiare.

Sipas administratës së KQZ-së gjatë diskutimit të këtij udhëzimi, vullneti i ligjvënësit kur u krye amendimi i vitit të shkuar, ishte heqja e kësaj garancie të shprehur në Kodin e mëparshëm.

Amendimi i kryer në këtë nen, sipas administratës, u bë që plotësimi i kuotës gjinore mos të ishte pengesë për subjektet zgjedhore, ndërkohë që fryma dhe qasja e të gjithë aktorëve për këtë çështje ka qenë krejt i kundërt përgjatë reformës elektorale.

Në të njëjtën linjë me administratën e trajtoi dhe e votoi udhëzimin edhe KQZ. Zbatimi i sanksionit plotësues sikundër e trajton Kodi Zgjedhor në nenin 175 pika 2, nuk siguron kushtin e përfaqësimit me së paku 30 % nga një gjini në rastin kur depozitohet një listë kandidatësh me më pak se 30 % nga ajo gjini. Madje ky sanksion as nuk mund të zbatohet kur lista e depozituar përbëhet nga kandidatë të vetëm një gjinie.

Ky udhëzim nuk e sqaron paqartësinë e ligjit mbi respektimin e kuotave gjinore, duke e bërë jo efektiv në tërësi këtë dispozitë të Kodit Zgjedhor.

b. Vendimi Nr. 172, datë 27.02.2013, “Për unifikim e praktikës së vlerësimit të fletëve të votimit nga personat ngarkuar nga Kodi Zgjedhor, për numërimin dhe vlerësimin e votave”.

Në hartimin e këtij vendimi Komisioni Qendror i Zgjedhjeve udhëhiqet nga vendosja e kriterëve se kush do të quhen vota të pavlefshme.²⁴

²³ Neni 67, pika 6 “Për çdo zonë zgjedhore, të paktën tridhjetë për qind e listës shumëemërore dhe një në tre emrat e parë të listës shumëemërore duhet t’i përkasë secilës gjini. Subjekti paraqitës i listës deklaron vendet, sipas kuotës gjinore, me qëllim zbatimin e përjashtimit, sipas pikës 2 të nenit 164 të këtij Kodi”.

²⁴ Vendimi Nr. 172, datë 27.02.2013, “Për unifikimin e praktikës së vlerësimit të fletëve të votimit nga personat ngarkuar nga Kodi Zgjedhor, për numërimin dhe vlerësimin e votave”.

“Sipas këtij përcaktimi vota të vlefshme janë vetëm fletët e votimit, në të cilat është votuar qartësisht vetëm për njërin nga subjektet zgjedhore apo partinë politike pjesëtare të koalicionit në fletën përkatëse të votimit.

Ndërsa vota të pavlefshme janë fletët e votimit kur:

a) fleta e votimit nuk ka të njëjtën madhësi, ngjyrë ose formë me fletën e votimit të miratuar nga KQZ-ja;

b) fletës së votimit i mungojnë vulat e parashikuara në nenin 103 të këtij Kodi;

c) në fletën e votimit janë bërë shënime apo shenja që bëjnë të pamundur vlerësimin e votës;

Pavarësisht se Kodi Zgjedhor ka këtë qasje, nisur nga eksperiencat e mëparshme, KQZ duhet të nisej nga logjika e vendosjes së kriterëve se kush do të quhet votë e vlefshme. Pra do të ishte më efikase që KQZ-ja të unifikohte mënyrën të shënimit të votës nga zgjedhësi dhe jo të kundërtën, pasi lihet shumë shteg për keqinterpretime.

3. Shkelje procedurale

a. Vendimmarrje me përmbajtje boshe (*Pa ratio legis dhe voluntas legis*)

Në dy vendimet²⁵ e marra në lidhje me caktimin e ZAZ-ve dhe për ndarjen e mandateve, KQZ-ja ka miratuar dy akte, ku shprehet se heq dorë prej vendimmarrjes.

KQZ, sipas Kodit Zgjedhor, ka detyrim absolut për të marrë vendim.

Vendimi i marrë nga KQZ-ja për të mos marrë vendim, përveçse është heqje dorë dhe mospërmbushje e detyrimit ligjor, është edhe një akt që formalisht është pa përmbajtje.

b. Moscaktimi i rendit të ditës për mbledhjen pasardhëse

Kodi Zgjedhor parashikon se në fund të çdo mbledhje të KQZ-së përcaktohet rendi i ditës për mbledhjen pasardhëse²⁶.

Në asnjë nga mbledhjet e KQZ-së nuk është përcaktuar rendi i ditës për mbledhjen pasardhëse sikundër kërkohet dhe është përcaktuar në Kodin Zgjedhor. Madje, edhe data se kur do të mbahet mbledhja e radhës është bërë e ditur në përfundim të fare pak mbledhjeve të KQZ-së.

Në përgjithësi, njoftimi për mbledhjet e KQZ-së bëhet një ditë përpara, dhe shpesh më pak se 24 orë përpara fillimit të mbledhjes.

Një praktikë e tillë e bën të vështirë përgatitjen paraprake të komisionerëve si dhe subjekteve politike apo të subjekteve të tjera të interesuar për çështjet që do të trajtohen në atë mbledhje.

Për më tepër, mungesa e kohës së mjaftueshme në dispozicion limiton mundësinë e informimit më të plotë dhe komunikimit paraprak midis komisionerëve dhe administratës, apo edhe të një konsultimi paraprak ndërmjet vetë komisionerëve.

c. Refuzim i kërkesës së dy anëtarëve për të futur çështje të reja në rendin e ditës

Dispozita²⁷ mbi këtë pikë në Kodin Zgjedhor nuk lë hapësirë për keqkuptim. Pakica e mendimit në KQZ, e përbërë së paku prej dy komisionerësh, ka të drejtë të vendosë në mënyrë automatike dhe pa filtrim çështje të reja në rendin e ditës.

ç) në fletën e votimit janë bërë shënime në favor ose në disfavor të subjekteve të caktuara zgjedhore;

d) është votuar për më shumë se një nga subjektet zgjedhore në fletën e votimit;

dh) nuk është votuar për asnjë nga subjektet zgjedhore në fletën e votimit;

e) nuk është e qartë se për kë është votuar; ose

ë) zgjedhësi ka votuar për një person apo subjekt që nuk është në fletën e votimit.”

²⁵ Vendimi Nr. 20, datë 21.12.2012, “Për mosmiratimin e ndarjes se re të zonave të administrimit zgjedhor për Zgjedhjet për kuvendin 2013”, si dhe Vendimi Nr. 15, datë 23.11.2012, “Për caktimin e numrit të mandateve për çdo zonë zgjedhore të zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë të vitit 2013”.

²⁶ Neni 22, pika 2 “Mbledhjet e KQZ-së mbyllen me caktimin e rendit të ditës për mbledhjen pasardhëse.”

²⁷ Neni 22, pika 1 “Mbledhjet e KQZ-së thirren nga Kryetari ose të paktën nga dy anëtarë të KQZ-së. Në çdo rast, thirrja e mbledhjes nuk i nënshtrohet votimit dhe duhet të përmbajë rendin e ditës të mbledhjes. Në rendin e ditës përfshihet çdo kërkesë e ardhur nga të paktën dy anëtarë të KQZ-së.”

Kërkesat janë paraqitur në mbledhjet e datave 27.12.2012, 15.01.2013, si dhe në mbledhjen e datës 28.01.2013 për shqyrtimin e vendimit “Caktimi i numrit të mandateve për çdo zonë zgjedhore të zgjedhësve për Kuvendin e Shqipërisë të vitit 2013.”

Shqyrtimi i natyrës së çështjes apo trajtimi i saj është një moment i dytë i cili trajtohet gjatë mbledhjes së KQZ-së, pasi është bërë pjesë e rendit të ditës.

Në rastin e mbledhjes së datës 15.01.2013, dy komisionerët e propozuar nga Partia Socialiste kërkuan të vendosin në rendin e ditës dhënien e informacionit në lidhje me një shkresë të Sekretares së Përgjithshme dërguar Kuvendit, kërkesë për të cilën nuk duhet investuar mbledhja e KQZ-së.

Kryetarja me argumentin që kërkesa për informacion nuk përbën projekt-akt, vendosi që kërkesa nuk mund të bëhet pjesë e rendit të ditës.

Argumentimi i Kryetares së KQZ-së është i drejtë, por nisur nga dispozita e Kodit Zgjedhor, kërkesa duhet të futej në rendin e ditës dhe në shqyrtimin e saj t'i bëhet ditur komisionerëve parregullsia e kërkesës.

4. Shtyrje të pikave të parashikuara për rendin e ditës

Vendimmarrja e KQZ-së në gjashtë çështje të rëndësishme është zvarritur apo shtyrë pa shkaqe objektive të qëndrueshme.

a. *“Miratimi i ngritjes së Zonave të Administrimit Zgjedhor (ZAZ) për zgjedhjet për Kuvendin 2013”*, datë 21.12.2012.

Vendimmarrja u shty pasi nuk u arrit shumica e cilësuar prej 5 votash për votimin e aktit.

Mungesa e vullnetit për ta trajtuar teknikisht çështjen sikundër është, si dhe politizimi pa shkak i saj, i shoqëruar edhe me mosprofesionalizimin e administratës së KQZ-së, e cila në pak ditë përgatiti projekt-vendimin njëherë variantin me 76 ZAZ dhe njëherë variantin me 89 ZAZ, e bëri të pamundur arritjen e shumicës së cilësuar të votimit, duke e lënë vendimmarrjen në duart e Kolegjit Zgjedhor.

b. *“Miratimi i disa shtesave dhe ndryshimeve në vendimin nr. 26, datë 03.03.2005 “Për miratimin e Rregullores për Organizimin dhe Funkcionimin e KQZ-së”*, datë 28.12.2012.

Vendimmarrja u shty pa u shtruar fare për shqyrtim, pas propozimit të përfaqësuesve të partive politike në KQZ për ta shqyrtuar në mbledhjen më të parë, për të cilët ranë dakord edhe komisionerët e KQZ-së.

Vendimmarrja mbi këtë akt nuk ka mundur të merret as në zgjedhjet parlamentare të 2009 dhe as në ato Vendore të 2011.

Ende sot KQZ është pa rregullore të brendshme.

c. *“Miratimi i strukturës organike dhe strukturës së pagave të punonjësve të administratës së KQZ-së”*, datë 28.12.2012.

Akti i përgatitur prej administratës ishte i paplotë në zërat e shpenzimeve. Kjo i detyroi komisionerët të binin dakord që ta shtynin këtë pikë, për t'i dhënë kohë administratës të saktësonte aktin.

d. *“Për miratimin e strategjisë së edukimit të zgjedhësve për zgjedhjet për Kuvendin të datës 23.06.2013”*, datë 05.02.2013

Akti i përgatitur prej administratës ishte i paplotë në strategjitë e edukimit përsa i përket fushatës publicitare që duhet të bënte KQZ-ja dhe kishte disa gabime në strategjinë e ndjekur ndaj minoriteteve etnike.

Kjo paplotësi i detyroi komisionerët ta shtynin këtë pikë për ta marrë në shqyrtim më vonë, për t'i dhënë kohë administratës të saktësonte elementët e kritikuar

e. "Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në udhëzimin Nr. 2, datë 25.02.2009, për organizimin dhe funksionimin e KZAZ", datë 07.02.2013

Përfaqësuesit e subjekteve zgjedhore shfaqën shqetësime mbi aktin në lidhje me çështjen e plotësimit të vakancave në Komisionet Zonale të Administrimit Zgjedhor. Gjatë diskutimeve në lidhje me këtë çështje u evidentua se ishte e nevojshme që administrata të punonte më shumë me aktin, por njëkohësisht edhe subjektet zgjedhore kishin nevojë për më shumë kohë për t'u përgatitur në lidhje me aktin.

f. "Për miratimin e strukturës së shpenzimeve buxhetore për zgjedhjet për Kuvendin, të datës 23 Qershor 2013", datë 22.02.2013

Akti i përgatitur prej administratës ishte i paplotë në zërat e shpenzimeve. Kjo i detyroi komisionerët të binin dakord që ta shtynin këtë pikë, për t'i dhënë kohë administratës të saktësonte aktin.

5. Komisionerët e KQZ-së

Anëtarët e KQZ-së në zbatim të ligjit dhe në frymën e Kodit Zgjedhor duhet të sillen si një trupë kolegjiale, profesionale, e pavarur dhe e paanshme që komunikojnë dhe bashkëpunojnë ngushtë jo vetëm me njëri-tjetrin, por edhe me administratën e KQZ-së.

Në sjelljen e deritanishme është vënë re një **sjellje shpesh e orientuar sipas debatit politik** midis partive në opinionin publik, apo edhe orientim sipas qëndrimit të përfaqësuesve të partive politike në KQZ.

Në dy vendimmarrjet më të rëndësishme për të cilën kërkohej shumicë e cilësuar votimi (ndarja e ZAZ-ve dhe caktimi i mandateve për çdo ZAZ) u konstatuan qëndrime të theksuara politike, ndërkohë që procesi në lidhje me këto dy çështje ishte thellësisht teknik.

Perceptimi i anëtarëve të KQZ-së si të anshëm ushqehet akoma më shumë nga vetë komisionerët. Gjatë momenteve të debateve, **komisionerët emërtojnë njëri-tjetrin si shumicë apo pakicë**, apo bëjnë aluzione mbi përkrahje politike, si argumente zhvleftësuese ndaj qëndrimeve të njëri-tjetrit.

Në vendimet mbi çështjet që kanë ndikim të theksuar politik ose për të cilat ka qëndrime politike të ndryshme, vihet re një **votim në bllok i ndarë qartazi** në palën e "shumicës" dhe atë të "pakicës". Kjo bën që diskutimi në seancë të mos bazohet në argumente, por të kthehet në debat me qëndrime të prera.

Në disa raste është vënë re **mungesë profesionalizmi e anëtarëve të KQZ-së** në argumentimet që përdorin apo hapat që ndërmarrin.

- Përmendim rastin kur *anëtarët e propozuar nga opozita bllokuan pa shkak vendimmarrjen e KQZ-së për caktimin e numrit të mandateve për çdo zonë zgjedhore*²⁸.

Çdo anëtar i KQZ-së ka të drejtë të kërkojë çfarëdolloj informacioni zyrtar nga institucionet e tjera, të cilat janë të detyruara t'ua japin. Mosmarrja e këtij informacioni nuk mund të përbëjë shkak për të mbajtur peng një vendimmarrje të caktuar.

Për më tepër që në rastin në fjalë, KQZ duhet të merrte një vendim mbi një informacion zyrtar të ardhur nga Ministria e Brendshme mbi numrin e popullsisë mbi bazë qarku. Fakti që mund të ketë pikëpyetje apo dyshime për mënyrën si janë bërë lëvizjet e popullsisë, konkretisht në qarkun e Kukësit, nuk ndryshon asgjë në lidhje me

²⁸ Shih për më shumë "Letrën e Hapur" të KVV-së, datë 19.01.2013 tek aneksi 5 i këtij raporti ose tek: <http://www.zgjedhje.al/index.php?idart=37&gj=sh>

ligjshmërinë dhe vlefshmërinë e dokumentit zyrtar të lëshuar nga Ministria e Brendshme. Rrjedhimisht, vendimmarrja e KQZ mbi këtë informacion është thjesht një çështje e qartë dhe teknike.

Kushtëzimi i kësaj vendimmarrje me informacionin rreth lëvizjeve, ishte një veprim me natyrë politike, çka dëmtoi mjaft gjithë këtë proces, duke rezultuar në fund me një ndarje mandatesh sipas popullsisë së 4 viteve më parë.

- Rasti i kërkesës nga komisionerët e propozuar nga PS për futjen në rendin e ditës në mbledhjen e KQZ-së të datës 15.01.2013, për marrjen e një informacioni nga Sekretarja e Përgjithshme e KQZ-së për një shkresë përcjellëse që kjo e fundit i kishte dërguar Kuvendit në lidhje me mandatet e zonave zgjedhore, është jo profesional.

- *Mosdhënia e direktivave të qarta nga KQZ-ja mbi objektivin e punës së auditëve teknikienë*, e bën punën e tyre diskretive dhe jo rezultative. Për më tepër mospërcaktimi i formave dhe mënyrave të njësuar të raportimit, e shndërron këtë proces verifikimi dhe konstatimi problemesh, në një proces gjenerimi të dhënash të debatueshme politikisht.

Vërehet se **komisionerët nuk konsultohen me njëri-tjetrin paraprakisht mbi aktet e rendit të ditës**. Shihet që ka shumë propozime të stisura aty për aty gjatë mbledhjes dhe jo të diskutuara më parë. Kjo sjell një mbingarkesë në diskutime dhe jo efikasitet në vendimet që mund të merrte KQZ-ja.

Konstatohet se **komisionerët në lidhje me çështje teknike të administrimit të zgjedhjeve, janë të pa informuar dhe të pa konsultuar** me ekspertët e nevojshëm, në mënyrë që të kenë një vlerësim mbi çështjen.

Në rastet e diskutimeve të çështjeve me natyrë teknike, për të cilat nuk ka qasje politike, evidentohet se në tërësi nuk ka diskutime apo sugjerime, por pranohet në bllok sugjerimi i administratës së KQZ-së.

Një pjesë e diskutimeve gjatë të cilave ka qëndrime të ndryshme midis komisionerëve, degradojnë në debate të ashpra në të cilat ata **humbasin etikën e komunikimit**, madje në disa raste ky komunikim nga zyrtar shndërrohet në një komunikim personal.

6. Marrëdhënia e komisionerëve me administratën e KQZ

Kodi Zgjedhor e konsideron organin e KQZ-së si një organ kolegjal i cili duhet të funksionojë si një trupë e vetme, organike dhe funksionale. Në këtë funksionim padyshim pjesa e efikasitetit dhe rendimentit të administratës zgjedhore është komponenti më i rëndësishëm.

Konstatohet se **komisionerët komunikojnë me administratën si me një trupë të huaj**. Komunikimi dhe bashkëpunimi midis tyre nuk rezulton si ai i një institucioni të vetëm, por si një marrëdhënie midis dy trupash të ndryshme.

Të gjitha palët (komisionerët dhe përfaqësuesit e partive politike në KQZ) **kanë një komunikim dhe sjellje interoguese dhe intimiduese ndaj administratës së KQZ-së**. Përveç anëtarëve të KQZ-së, përfaqësuesit e subjekteve politike nuk mund dhe nuk duhet t'i drejtohen drejtëpërsëdrejti administratës përgjatë mbledhjeve të KQZ-së. Ky komunikim duhet gjithmonë të kalojë nga KQZ-ja .

Vërehet se **administrata e KQZ-së ka lidhje vetëm dhe direkt me Kryetaren e KQZ-së**, ndërkohë që kjo marrëdhënie duhet të jetë më të gjithë komisionerët.

7. Administrata e KQZ-së

Në funksionimin e administratës së KQZ-së vërehen një sërë shqetësimesh.

Materialet paraprake që përgatit administrata për t'u shqyrtuar dhe aprovuar në mbledhjet e KQZ-së, në disa raste **nuk janë të plota** dhe bëhen shkak për të shtyrë vendimmarrjen në një moment të dytë.

Por ka edhe raste kur si pasojë e pasaktësive të administratës, KQZ rimerr në shqyrtim aktet e miratuara më parë, për të marrë një vendim të ri.

Siç është rasti i rimarrjes së vendimit për shpërndarjen e fondeve partive politike. Për shkak të marrjes gabim të shumës totale të fondit në dispozicion, vendimi i marrë nga KQZ më datën 15 janar u rimorr edhe një herë në datën 5 shkurt. Përsëri në rishqyrtimin e dytë, pas tërheqjes së vëmendjes nga anëtarët e KQZ-së për pasaktësi, administrata kërkoi kohë në dispozicion për t'i riparë edhe njëherë materialet paraprake.

Nuk mungojnë **kontradiktat midis përfaqësuesve të administratës** gjatë mbledhjeve të KQZ-së, duke krijuar ngërçe të panevojshme në përgatitjen e materialeve paraprake.

Vërehen **lapsuse të shpeshta në materialet paraprake** që dorëzohen në mbledhjet e KQZ-së.

Administrata komunikon vetëm më Kryetaren dhe jo me anëtarët e tjerë të KQZ-së.

8. Cënimi i ceremonialitetit

Ceremonialiteti i mbledhjeve të Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve është një aspekt shumë i rëndësishëm në ruajtjen dhe përcimin e seriozitetit si dhe të rritjes së rendimentit të punës së KQZ-së.

Është konstatuar se mbledhjet shpesh **nuk nisin në orën e paralajmëruar**, por rreth 10 apo 15 minuta me vonesë.

Kryetarja e KQZ-së nuk arrin të ruajë **rregullin dhe baraspeshën gjatë diskutimeve**. Shpesh herë disa palë janë më të toleruara në kohë dhe në ndërhyrje sesa të tjerat.

Pushimet që kërkohen në mes të mbledhjeve, me arsyetimin për t'u konsultuar apo qetësuar, **shkojnë përtej kohës së deklaruar**.

Shpesh përgjatë mbledhjeve konstatohen **biseda të zhurmshme apo lëvizje** të shumta nëpër sallë të të pranishmëve.

Kryetarja e KQZ-së disa herë ka tërhequr vëmendjen, por masat e marra prej saj nuk e kanë përmirësuar gjendjen, ndaj KQZ-ja duhet të marrë masat e nevojshme për parandalimin e këtyre situatave.

Në jo pak raste përgjatë mbledhjeve, janë krijuar **situata hilariteti ndërmjet vetë komisionerëve**. Madje shpesh vërehet mungesë e theksuar vëmendje e një/disa komisionerëve ndaj njëri-tjetrit, në momentin kur ata kanë fjalën.

Mbledhjet e KQZ-së janë të hapura dhe transmetohen live në internet, dhe shpesh edhe nga televizionet. Kjo situatë shpesh përdoret nga **komisionerët për të bërë deklarata publike gjatë zhvillimit të mbledhjes**, siç ka bërë në disa raste nënkryetari i KQZ-së, ndërkohë që komisionerët duhet të sillen dhe ushtrojnë funksionin e tyre njësoj sikur mediat të mos jenë aty.

Nëse komisionerët ndiejnë nevojën e komunikimit direkt me publikun, kanë të gjitha mundësitë për ta bërë këtë pas përfundimit të mbledhjes së KQZ-së.

Përgjatë mbledhjeve të KQZ-së, shpesh vërehet ngritje tonesh gjatë debateve midis komisionerëve, si shkak, në përgjithësi, i **qëndrimeve këmbëngulëse dhe jo argumentuese**.

Ndërhyrjet e komisionerëve gjatë fjalimit që mban gjithsecili, janë shqetësuese, sepse debati nuk ndjek një rrjedhë dhe argumentimet e nisura nuk arrijnë të artikulohen të plota, çka e bën të vështirë arritjen e marrëveshjes në marrjen e vendimit.

Është për tu vlerësuar maksimalisht dhënia e aksesit të plotë medias për të transmetuar mbledhjet e KQZ-së. Por njëkohësisht, KQZ duhet të përcaktojë rregulla të qarta për **lëvizjen e gazetarëve dhe kameramanëve në sallë**, në mënyrë që të mos pengojë punën apo bezdisë anëtarët e KQZ-së.

D2. KOMISIONET E ZONAVE TE ADMINISTRIMIT ZGJEDHOR

Zgjedhjet Parlamentare të 23 Qershorit 2013 do të administrohen në nivelin e dytë nga 89 Komisione Zonale të Administrimit Zgjedhor.

KZAZ-të përbëhen nga shtatë anëtarë, të cilët emërohen sipas një formule përfaqësimi që synon të garantojë balancën politike.

Për zgjedhjet e ardhshme parlamentare, dy anëtarë të KZAZ-së propozohen nga Partia Demokratike, dy anëtarë propozohen nga Partia Socialiste, një anëtar propozohet nga Partia Lëvizja Socialiste për Integrim dhe një anëtar propozohet nga Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut²⁹.

Anëtar i shtatë në KZAZ-të me numër tek do të propozohet nga Partia Socialiste, ndërsa në KZAZ-të me numër çift propozohet nga Partia Demokratike³⁰.

Sekretari i KZAZ-ve është jurist dhe propozohet nga partia e cila propozon zëvendëskryetarin e komisionit (*neni 29/1/c*).

Kodi Zgjedhor parashikon zbatimin e kuotave gjinore për anëtarët e KZAZ-ve të propozuar nga partia Socialiste dhe partia Demokratike. Në nenin 29, pika 1, gërma ç parashikohet se 30 për qind e anëtarëve të propozuar përkatësisht nga partia më e madhe e shumicës dhe partia më e madhe e opozitës, në shkallë vendi, duhet të jenë nga secila gjini.

Më datën 10 Mars 2013 ishte afati për paraqitjen e kandidaturave për anëtarë të KZAZ-ve. Nga informacioni i marrë pranë KQZ-së, PD, LSI dhe PBDNJ i kanë dorëzuar më datën 8 Mars ndërsa PS i ka dorëzuar më datën 11 Mars 2013. Po nga ky informacion paraprak disa nga listat janë të paplota.

Procesi i Votimi në Zgjedhjet Parlamentare të 23 Qershorit 2013 do të administrohet nga 5505 Komisione të Qendrave të Votimi (KQV).

Komisioni i Qendrës së Votimi ndërtohet me të njëjtën formulë të ndërtimit të KZAZ-së. KQV-të emërohen nga KZAZ-të në çdo rast jo më vonë se data 3 Qershor 2013.

²⁹ Vendimi Nr. 1, datë 7.01.2013 “Për caktimin e partive politike që kanë të drejtë të paraqesin propozime për anëtarë të KZAZ-ve për Zgjedhjet për Kuvend të datës 23.06.2013”

³⁰ Vendimi Nr. 3, datë 7.01.2013 “Për shpalljen e rezultatit të shortit për caktimin e partisë që do të propozojë anëtarin e shtatë të KZAZ-ve”

D3. INSTITUCIONE TË TJERA QË PËRFSHIHEN NË NDËRTIMIN E INFRASTRUKTURËS ZGJEDHORE

Proçesi parazgjedhor dhe zgjedhor përgatitet edhe nga disa institucione të tjera shumë të rëndësishme.

1. Ministria e Brendshme

Ministria e Brendshme në lidhje me përgatitjen e procesit ka këto kompetenca të parashkuara nga Kodi Zgjedhor:

- a. Jo më vonë se 30 ditë nga dekretimi i datës së zgjedhjeve, publikon në faqen e internetit të RKGJC ekstraktin e zgjedhësve në shkallë vendi.³¹
- b. Mbulon shpenzimet për njoftimin me shkrim të zgjedhësve.³²
- c. Është përgjegjëse për publikimin e ekstrakteve të përbërësve zgjedhorë.³³
- d. Publikon listën përfundimtare të zgjedhësve.³⁴

Problematikat e vërejtura:

- a. Probleme me softëare e ngritur prej Ministrisë së Brendshme, i cili duhej të bentë ndarjen e listave të ekstrakteve të përbërësve zgjedhorë.
Ministria e Brendshme nuk dha shpjegime se cilat qenë shkaqet që programi i ndërtuar nuk bëri një ndarje të listave të votuesve në përputhje me Kodin Zgjedhor, duke e vonuar proçesin e publikimit në shkallë vendi.
Ende sot në njësitë vendore ka qendra votimi pa lista të shpallura ose probleme me votuesit me “Kodin 999”.
- b. Krijohet një vakancë gati një mujore (janar-shkurt) e vendit të Drejtorit të Përgjithshëm të Gjendjes Civile, në periudhën më delikate të publikimit të listave.
- c. Mos dhënie e mbështjës materiale për Zyrat e Gjendjeve Civile për shpenzime operative për publikimin e listave dhe përgatitjen e njoftimeve me shkrim.
- d. Dërgimi i modelit të njoftimit me shkrim të votuesve tek njësitë vendore atëhere kur afati ligjor që i detyron Kodi Zgjedhor kishte përfunduar. Duke i lënë kështu Njësitë Vendore pa asnjë detyrim ligjor për të vazhduar proçesin e njoftimit.
- e. Nuk ka lëshuar udhëzim të qartë sesi do të veprohet me njoftimin me shkrim të votuesve, tanimë që afati ka kaluar dhe si do bëhet vlerësimi i kryerjes ose jo i këtij njoftimi.
Prej disa Kryetarëve të Njësive Vendore bëhet e ditur iu është komunikuar që lëshimi i modeli i njoftimit me shkrim do të bëhej me 03.03.2013.

³¹ Neni 51, pika 5 “Jo më vonë se 30 ditë nga dekretimi i datës së zgjedhjeve, ministria që mbulon shërbimin e gjendjes civile dhe KQZ-ja publikojnë në faqet përkatëse zyrtare të internetit ekstraktin e zgjedhësve në shkallë vendi.”

³² Neni 52, pika 5 “Shpenzimet për njoftimin, sipas këtij neni, mbulohen nga ministria që mbulon shërbimin e gjendjes civile. Fondi përkatës u shpërndahet njësive të qeverisjes vendore në raport me numrin e zgjedhësve që ka çdo njësi e qeverisjes vendore.”

³³ Neni 51, pika 4 “Jo më vonë se 30 ditë nga dekretimi i datës së zgjedhjeve, zyrat e gjendjes civile, pas miratimit nga kryetari i njësive vendore, printojnë dhe publikojnë ekstraktin e përbërësve zgjedhorë të të gjithë shtetasve që kanë vendbanim në zonat e qendrave të votimit nën juridiksionin e çdo zyre. Publikimi bëhet në ambientet e zyrave të gjendjes civile ose në ambientet pranë tyre me akses të lirë për publikun.”

³⁴ Neni 56, pika 1 “Zyra e gjendjes civile harton listën e zgjedhësve për çdo zonë qendre votimi jo më vonë se 40 ditë para datës së zgjedhjeve, duke nxjerrë nga të dhënat elektronike të RKGJC-së të gjithë shtetasit që do të mbushin moshën 18 vjeç deri në datën e zhvillimit të zgjedhjeve dhe që kanë vendbanimin në zonat e qendrave të votimit nën juridiksionin e saj. Lista miratohet nga kryetari i njësive përkatëse të qeverisjes vendore.”

2. Njësitë e Qeverisjes Vendore

- a. Kryejnë njoftimin me shkrim të zgjedhësve³⁵
- b. Njofton KQZ-në për vendodhjen e Qendrave të Votimit.³⁶
- c. Njofton KQZ-në për numrin e zgjedhësve të verbër dhe qendrat e tyre të votimit³⁷.

Problematikat e vërejtura:

- a. Mosnjoftimi me shkrim i zgjedhësve me shkrim brenda datës 03.03.2012, që është afati ligjor.
- b. Mosdërgimi i listave me Qendrat e Votimit në Komisionin Qendror brenda datës 28.12.2013, që është afati ligjor. Një mosrespektim afati që në përputhje me ligjin u ndëshkua me sanksione financiare prej KQZ-së.³⁸
- c. Moshartimi i listave të personave të verbër.
- d. Gjatë punës së vëzhguesve është vënë re mungesë informacioni prej zyrtarëve vendorë në lidhje me detyrat që i jep ligji në lidhje me organizimin e zgjedhjeve.

3. Prefektët

- a. Në rastet e refuzimit të zbatimit të urdhërimeve të KQZ-së, nga NJQVnë lidhje me qendrat e votimit, njoftohet prefekti për zbatimin e vendimit për caktimin e qendrave të votimit³⁹.
- b. Prefekti i qarkut i paraqet KQZ-së listën e plotë të objekteve brenda territorit të qarkut, që përmbushin kushtet për të qenë Qendra të Numërimit të Votave⁴⁰

³⁵ Neni 52, pika 1 “Brenda 60 ditëve nga publikimi i ekstraktit të përbërësve zgjedhorë të zgjedhësve, sipas pikave 1, 2, dhe 3 të nenit 51, kryetari i njësisë së qeverisjes vendore kryen lajmërimin me shkrim për çdo zgjedhës të përfshirë në ekstraktin e përbërësve zgjedhorë të qendrave të votimit në njësinë përkatëse të qeverisjes vendore.”

³⁶ Neni 62, pika 9 “Jo më vonë se 10 ditë nga përcaktimi i qendrës së votimit, sipas këtij neni, kryetari i njësisë vendore është i detyruar të njoftojë KQZ-në. Njoftimi për vendndodhjen shoqërohet edhe me planimetrinë, llojin e objektit dhe informacione të tjera të përcaktuara në aktin normativ të KQZ-së.”

³⁷ Neni 108, pika 8 “Në rastin e zgjedhësve të verbër, kryetari i njësisë së qeverisjes vendore njofton KQZ-në për numrin e zgjedhësve të verbër dhe qendrat e tyre të votimit. KQZ-ja, në përputhje me procedurat dhe afatet e shpërndarjes së materialeve zgjedhore, pajis komisionet e këtyre qendrave të votimit me mjete të posaçme votimi, të cilat lejojnë zgjedhësit që të lexojnë ose të kuptojnë fletën e votimit dhe të votojnë në mënyrë të pavarur. Zgjedhësi i verbër informohet nga KQV-ja për mënyrën e votimit me mjete të posaçme votimi dhe, me kërkesën e tij, pajiset me to. Në rast të kundërt, zgjedhësi voton në përputhje me pikat 1 dhe 3 të këtij neni.”

³⁸ Vendimi Nr. 27, datë 22.02.2013, “Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi analizoi shkaqet e mosparaqitjes në kohë të materialit të kërkuar dhe dëgjoi kryetarët e njësive administrative të pranishëm në mbledhje vendosi:

- Të gjobisë në shumën 50.000 lekë 34 kryetarë të njësive të qeverisjes vendore që nuk kanë sjellë asnjë informacion në KQZ.

- Të gjobisë në shumën 25.000 lekë 28 kryetarë të njësive të qeverisjes vendore që kanë paraqitur informacionin e kërkuar jashtë afatit ligjor të parashikuar në Kodin Zgjedhor.

- Të gjobisë në shumën 15.000 lekë 57 kryetarë të njësive të qeverisjes vendore të cilët kanë depozituar pranë KQZ-së informacionin e kërkuar por që rezultoi me mangësi dhe jo në përputhje me ligjin.

- Të gjobisë në shumën 10.000 lekë 20 kryetarë të njësive të qeverisjes vendore të cilët kanë depozituar informacion në KQZ me mangësi por që në bashkëpunim me administratën e KQZ-së janë korrigjuar më pas.”

³⁹ Neni 62, pika 12 “Në rast të refuzimit të zbatimit të urdhërimeve të KQZ-së në lidhje me qendrat e votimit, KQZ-ja ndëshkon kryetarin e njësisë vendore me 50 000 deri në 100 000 lekë gjobë, si dhe njofton prefektin për zbatimin e vendimit për caktimin e qendrave të votimit. Gjoha përbën titull ekzekutiv dhe ekzekutohet sipas Kodit të Procedurës Civile.”

⁴⁰ Neni 94, pika 1 “Jo më vonë se 60 ditë para datës së zgjedhjeve, prefekti i qarkut i paraqet KQZ-së listën e plotë të objekteve brenda territorit të qarkut, që përmbushin kushtet e parashikuara në pikat 1 dhe 2 të nenit 93 dhe të këtij neni.”

4. Presidenti

Dekreton datën kur do të mbahen zgjedhjet⁴¹. Presidenti e dekretoi datën e zgjedhjeve më datën 3 Dhjetor 2012.

Ndonëse detyrimi ligjor i Presidentit për dekretimin e datës së zgjedhjeve ka qene brenda cakut ligjor, nëse dekretimi do të ishte kryer më herët në kohë dhe jo në skajin e fundëm kohor, do i ishte dhënë më shumë kohë operatorëve të tjerë zgjedhorë të kryenin detyrimet e tyre.

5. Këshilli i Lartë i Drejtësisë

Hedh shortin për përzgjedhjen e tetë gjyqtarëve nga Gjykata e Apelit Tiranë për konstituimin e Kolegjit Zgjedhor⁴². Ky short u hodh në datën 7 dhjetor 2012.

E. LISTAT DHE IDENTIFIKIMI I ZGJEDHËSVE

Lista e Zgjedhësve, si një mjet që sanksionon të drejtën e qytetarëve për të shprehur vullnetin e tyre, përbën një ndër elementët më thelbësor të ndërtimit dhe realizimit të një procesi zgjedhor ligjor, të drejtë dhe të ndershëm.

Lista e Zgjedhjeve është produkt i Regjistrimit Kombëtar të Gjendjes Civile. Ajo përfshin të gjithë shtetasit të cilët në ditën e votimit mbushin moshën 18 vjeç.

Votuesi si rregull duhet të figurojë në listën e zgjedhësve të qendrës së votimit që është ngritur pranë vendbanimit të tij. Kategori të caktuara zgjedhësish përfshihen në listat e zgjedhësve të qendrave të posaçme të votimit sipas përcaktimeve që bëhen në Kodin Zgjedhor.

Kodi Zgjedhor parashikon me detaje procesin e përgatitjes së listave paraprake si dhe procesin e verifikimit dhe të saktësimin të tyre. Për këto zgjedhje ka 5 afate të publikimit të ekstrakteve zgjedhore, çdo 30 ditë duke filluar nga data 3 janar 2013, deri në miratimin e listës përfundimtare në 13 Maj 2013.

Koalicioni tërhoqi vëmendjen për rëndësinë dhe problematikën e shfaqur në lidhje me listat, nëpërmjet 3 deklaratave për shtyp⁴³.

1. Publikimi i Ekstraktit të Parë të përbërësve zgjedhorë.

Sipas dispozitave ligjore të parashikuara në Kodin Zgjedhor (*Neni 51, pika 4 e Ligjit Nr. 10 019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar me Ligjin Nr. 74/2012 datë 19.07.2012*): “Jo më vonë se 30 ditë nga dekretimi i datës së zgjedhjeve, zyrat e gjendjes civile, pas miratimit nga kryetari i njësisë vendore, printojnë dhe publikojnë ekstraktin e përbërësve zgjedhorë të të gjithë shtetasve që kanë vendbanim në zonat e qendrave të votimit nën juridiksionin e çdo zyre. Publikimi bëhet në ambientet e zyrave të gjendjes civile ose në ambientet pranë tyre me akses të lirë për publikun”.

⁴¹ Neni 9, pika 2 “Presidenti i Republikës nxjerr dekretin për caktimin e datës së zgjedhjeve për Kuvendin jo më vonë se 9 muaj para mbarimit të mandatit të Kuvendit. Me vendim të Kuvendit, mbyllja e legjislaturës ose shpërndarja e tij bëhen jo më shpejt se 45 ditë para datës së caktuar për zgjedhjet dhe jo më vonë se 30 ditë para kësaj date.”

⁴² Neni 146, pika 2 “Në shortin e hedhur nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë për përzgjedhjen e tetë gjyqtarëve, që përbëjnë Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës së Apelit, Tiranë, përfshihen emrat e të gjithë gjyqtarëve të të gjitha gjykatave të apelit të Republikës së Shqipërisë, me përjashtim të atyre të përcaktuar në nenin 148 të këtij Kodi.”

⁴³ Shih deklaratën në Aneksin 4 ose tek <http://www.zgjedhje.al/index.php?idart=36&gj=sh>, në Aneksin 6 ose tek <http://www.zgjedhje.al/index.php?idart=38&gj=sh> si dhe në Aneksin 7 ose tek <http://www.zgjedhje.al/index.php?idart=39&gj=sh>.

Po ashtu udhëzimi nr. 374 datë 10.12.2012 i Ministrisë së Brendshme (Pika 12 Udhëzimit Nr. 374, datë 10.12.2012 "*Për procedurat e hartimit të listave të zgjedhësve për zgjedhjet për Kuvendin*"), jep detaje të hollësishme për NJ.Q.V-të se si duhet të bëjnë këto publikime.

“Zyrat e gjendjes civile në bashki/komuna/njësi bashkiake, brenda datës 3 janar 2013, printojnë dhe publikojnë, pasi të firmoset nga kryetari përkatës, ekstraktin e parë të përbërësve zgjedhorë të të gjithë zgjedhësve, sipas vendbanimit dhe qendrave të votimit, nën juridiksionin e tyre territorial. Ekstrakti i përbërësve zgjedhorë, me të njëjtat kritere, do të printohet dhe publikohet edhe çdo 30 ditë sipas përcaktimit të Kodit Zgjedhor. DPGJC-ja publikon këto ekstrakte në shkallë vendi, në faqen e saj zyrtare, si dhe ia dërgon KQZ-së për publikim në faqen e saj zyrtare”.

Të gjitha njësitë vendore duhet që brenda datës 3 Janar 2013 të kishin përgatitur, printuar dhe publikuar në ambientet e Zyrave të Gjendjes Civile, ose në ambientet pranë tyre me akses të lirë për publikun, ekstratin e parë të përbërësve zgjedhorë të të gjithë zgjedhësve

Nga monitorimi i kryer rezultoi se vetëm pak njësi vendore i publikuan listat paraprake të plota psh. Njësia Bashkiake Nr. 3 - Tiranë, Bashkia e Këlcyrës - Përmet, Bashkia Burrel, etj. Disa NjQV i publikuan ato pjesërisht dhe po punonin për ndreqjen e gabimeve në pjesën tjetër të listave psh. Njësia Bashkiake Nr. 4, Nr. 7 dhe Nr. 11 - Tiranë, etj.

Kishte edhe njësi të cilat i publikuan listat duke i shpërndarë në vende publike pranë qendrave të mundshme të votimit, dhe jo pranë zyrës së gjendjes civile sikundër parashikohet në ligj psh. Njësia Bashkiake Nr. 11 - Tiranë, Bashkia Kukës, etj.

Një pjesë e NJQV-ve në këtë periudhë ishin duke bërë riformatimin e qendrave të reja të votimit në bazë të Kodit Zgjedhor, i cili parashikon ndarjen e qendrave me me shumë se 1000 zgjedhës dhe shkrijen e atyre me më pak se 200 zgjedhes. Kjo u konstatua kryesisht në Vlorë, Tiranë, Korçë, etj.

U konstatua se një pjesë e NJQV-ve kishte probleme me bazën materiale si letër dhe bojë, psh. bashkia Përmet, Njësia bashkiake nr. 5 Tiranë, etj.

Përgjatë vëzhgimit të bërë në atë periudhë, u evidentuan disa raste kur administrata e NJQV-ve nuk kishte dijeni të afatit ligjor të publikimit.

Në ekstratin e parë zgjedhor u evidentuan edhe pasaktësi të tjera, madje rezultuan qendra votimi pa asnjë të dhënë siç ishte rasti i QV Nr. 1699 në Njësinë Bashkiake Nr. 1, në Tiranë.

Sipas zyrtarëve të Njësive Bashkiake, Zyrtarët e RKGJC-së kanë pranuar gabimet në lista për shkak të një gabimi kompjuterik, madje kanë qene këta të fundit që iu kanë kërkuar atyre të ndërpresin procesin e shpalljes së listave paraprake deri në saktësimin e tyre.

2. Publikimi i Ekstraktit të Dytë të përbërësve zgjedhorë.

Duke iu referuar nenit 51/7 "*Publikimi, sipas pikës 4 të këtij neni, përsëritet në mënyrë periodike çdo 30 ditë deri në shpalljen e listës së zgjedhësve. Çdo publikim duhet të pasqyrojë çdo ndryshim të përbërësve zgjedhorë të RKGJC-së që është bërë nga publikimi paraardhës deri në momentin e publikimit të ri.*" Sipas këtij neni njësitë e qeverisjes vendore duhej që në datën 3 shkurt 2013 të kishin nxjerrë ekstraktin e dytë të listave të zgjedhësve.

Edhe në afatin e dytë të publikimit të listave paraprake , u konstatua me shqetësim se ende një pjesë e konsiderushme e Drejtuesve të Institucioneve Vendore dhe atyre Qëndrore të përfshira në këtë proces, trajtuan me një mungesë të lartë përgjegjshmërie afatet ligjore të parashikuara, pavarësisht arsyeve teknike (objektive ose jo) që ata parashtruan.

Në një pjesë të madhe të njësive vendore u bë publikimi i listave (*si në Berat, Peshkopi, Gramsh, Tepelenë, Kukës, Pukë, Nj. B. Nr. 10 Tiranë, Sarandë, etj.*) si edhe përcaktimi dhe dërgimi i vendndodhjes së qendrave të votimit.

Ndërkohë kishte NJQV ku listat nuk ishin publikuar fare deri në këtë datë (*si në qytetet Elbasan, Gjirokastrë, Kavajë, Nj. B. Nr. 2 Tiranë, listat ende nuk janë publikuar. Në Shkodër, prej njësisë vendore thuhet se listat janë publikuar nëpër qendrat e votimit, por nuk gjenden të shpallura ende në këto të fundit. Në Vlorë listat janë saktësuar dhe shpallur pjesërisht.*).

U evidentuan NJQV ku u publikuan me vonesë listat e ekstratit të parë, por akoma nuk ishin publikuar listat e korigjuara të ekstratit të dytë të 3 shkurtit (*si në qytetin e Bajram Currit, Korçës, Nj.B. Nr. 2, 6, 8, 9 dhe 11 Tiranë, Përmet, etj.*).

Po ashtu u evidentuan Njësi të Qeverisjes Vendore ku ende nuk ishte bërë përcaktimi i QV-ve dhe dërgimi i tyre Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (*si në Durrës, Librazhd, Fier, Bilisht, etj.*).

3. Publikimi i Ekstraktit të Tretë të përbërësve zgjedhorë.

Edhe publikimi i këtij ekstrakti u shoqërua me problematika të ndryshme.

Vazhdon të mbesë problematik mosfurnizimi i zyrave të gjendjes civile pranë NJQV-ve me bazën materiale.

Në Njësinë Bashkiake Nr. 7, ka një qëndër votimi pa lista dhe me anëtarë të së njëjtës familje të ndarë në QV të ndryshme.

Në këtë fazë të tretë të publikimit të listave vërehet një numër i madh votuesish me kodin 999 (votuesit pa adresë) dhe ende nuk ka asnjë udhëzim se si do operohet me këta zgjedhës.

Njësia Bashkiake Nr. 2 në Tiranë nuk ka afishuar fare listat. Po ashtu në bashkinë e Përmetit nuk janë afishuar asnjëherë listat paraprake të zgjedhësve. Ka edhe NJQV të cilët nuk e kanë njohuri mbi detyrimin ligjor, si është Komuna Dajt, etj.

Në datën 3 mars 2013, përveç se duhet të ishin publikuar lista të reja me korigjimet përkatëse, duhet të kishte përfunduar edhe lajmërimi me shkrim i çdo zgjedhësi për qendrën e votimit, vendndodhjen dhe adresën e saj, si dhe numrin rendor të zgjedhësit në listën e zgjedhësve të asaj qendre votimi.

Data 3 mars është përfundimi i detyrimit të vetëm ligjor që ka shteti shqiptar për të informuar me shkrim dhe kundërfirmë qytetarin se nëse është në listë si edhe se ku do të votojë.

Sipas nenit 52/1 të Kodit Zgjedhor “*Brenda 60 ditëve nga publikimi i ekstraktit të përbërësve zgjedhorë të zgjedhësve, sipas pikave 1 dhe 2 të nenit 51, kryetari i njësisë së qeverisjes vendore kryen lajmërimin me shkrim për çdo zgjedhës të përfshirë në ekstraktin e përbërësve zgjedhorë të qendrave të votimit në njësinë përkatëse të qeverisjes vendore. Njoftim bëhet edhe për shtetasit që kanë mbushur 100 vjeç, sipas të dhënave në RKGJC, duke i njoftuar ata për arsyen e mospërfshirjes në listë”.*

Kodi Zgjedhor në nenin 52 pika 4, parashikon që Kryetarët e Njësive të Qeverisjes Vendore duhet të raportojnë për përmbushjen e këtij detyrimi, sipas Udhëzimit të Ministrit të Brendshëm, ndërkohë që në Udhëzimin Nr. 374 datë 10.12.2012 "*Për procedurat e hartimit të listave të zgjedhësve për zgjedhjet për Kuvendin*", nuk ka asnjë parashikim për mënyrat e raportimit apo të verifikimit nëse është përmbushur apo jo një detyrim i tillë ligjor.

Për më tepër, nga monitorimet e bëra edhe në ato njësi të cilat i kanë shpallur listat, procesi i njoftimit të qytetarëve nuk filloi përpara datës 3 Mars, pasi Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile nuk kishte gjeneruar pranë Njësive të Qeverisjes Vendore "Modelin nr. 1", të përcaktuar me udhëzim për njoftimin e qytetarëve.

Njëkohësisht, Ministria e Brendshme akoma nuk u ka kaluar Njësive të Qeverisjes Vendore fondin përkatës për mbulimin e shpenzimeve për njoftimin, sikundër parashikohet në nenin 52, pika 5 të Kodit Zgjedhor.

Pas datës 3 Mars raportohet se është gjeneruar modeli i njoftimit të qytetarëve dhe ka filluar procesi i njoftimit të tyre.

Ky njoftim ndryshe nga sa ishte parashikuar në Kod, tani bëhet vetëm duke lënë njoftimin në banesën që mendohet se banon zgjedhësi, dhe nuk merret kundërfirma e tij. Ky proces ka nisur, sipas informacioneve të marra, mbi bazën e udhëzimeve me gojë nga Ministria e Brendshme, ndërkohë që nuk ka asnjë dispozitë ligjore mbi të cilën të mbështetet ky proces, pasi afati i zbatimit të dispozitës ishte deri më datën 3 Mars 2013.

Në lidhje me vendin e publikimit, disa NJQV i kanë shpallur pranë QV.

Publikimi i listave pranë qendrave të mëparshme të votimit nuk është aspak efektiv për tu kontrolluar nga qytetarët, pasi QV-të janë në institucione publike (si kopshte, çerdhe, shkolla, etj) të cilët funksionojnë me orar të kufizuar dhe jo me hyrje të lirë për publikun e gjerë. Kjo mënyrë publikimi, pavarësisht argumentit të mungesës së hapësirave të publikimit, është në shkelje të dispozitave të Kodit Zgjedhor (neni 51, pika 4) dhe të Udhëzimit të Ministrit të Brendshëm, si edhe nuk garanton aspak dispozitën për publikimin në ambiente me hyrje të lirë për publikun.

Procesi i publikimit të ekstrakteve zgjedhore në disa NJQV vazhdon të pengohet për shkak të mungesave të bazës materiale si letra apo boja e printerit.

F. FUSHATA ZGJEDHORE

Kodi Zgjedhor parashikon se fushata elektorale fillon 30 ditë përpara datës së zgjedhjeve dhe mbaron 24 orë përpara saj, kur fillon edhe heshtja elektorale.

Pra, fushata zgjedhore pritet të nisë më 23 maj 2013.

Vihet re me shqetësim se ky afat është shkelur dhe nuk po respektohet aspak prej partive kryesore politike, të cilat tashmë e kanë nisur fushatën elektorale⁴⁴.

- *Partia Demokratike*⁴⁵ në Shkodër, datë 15.01.2013

Kryetari i Partisë Demokratike, në vizitën e tij me rastin e 22 vjetorit të themelimit të Partisë Demokratike, bëri publikimin e motos elektorale.

⁴⁴ Fushata zgjedhore kuptohet si një "aktivitet politik i ndërmarrë për të nxitur fitoren apo humbjen elektorale të një kandidati ose disa kandidatëve për një zyrë shtetërore"

⁴⁵ <http://www.top-channel.tv/artikull.php?id=249640>

- *Partia Fryma e Re Demokratike*⁴⁶ në Malësi e Madhe, datë 28.01.2013
Kryetari i Partisë Fryma e Re Demokratike, në vizitën e tij në Malësinë e Madhe, bëri publikimin e motos elektorale.

- *Partia për Drejtësi dhe Unitet*⁴⁷ në Korçë, datë 29.01.2013
Kryetari i Partisë për Drejtësi dhe Unitet, në vizitën e tij në Korçë, prezantoi kandidatin për deputet në Qarkun e Korçës,.

- *Partia Socialiste* në Tiranë, datë 03.02.2013
Kryetari i Partisë Socialiste, në Selinë e Partisë Socialiste, prezantoi kandidatin për deputet në Qarkun e Elbasanit.

- *Partia Lëvizja Socialiste për Integrim*, datë 18.02.2013
Kryetari i Lëvizjes Socialiste, në vizitën e tij në Elbasan, hapi fushatën elektorale.

Partia Lëvizja e Legalitetit⁴⁸ çel fushatën elektorale në Kukës. 10/03/2013
Kryetari i PLL-së, në fjalën e tij vuri në dukje se, “me Kukësin nisim takimet elektorale që do të vazhdojnë në mbarë vendin...”.

Ndërkohë shqetësim mbetet zhvillimi i fushatës zgjedhore në institucionet publike veçanërisht në shkolla.

Përmendim këtu Kryeministrin z. Sali Berisha i cili inaugurimin e një shkolle profesionale në Kamëz, në datën 12.03.2013, e shfrytëzoi për të bërë fushatë⁴⁹.

Po ashtu shfrytëzimi i aktiviteteve të organizuara në kuadrin e institucioneve shtetërore të cilat shfrytëzohen për fushata elektorale partiake.

Përmendim këtu aktivitetin festiv të organizuar në kuadrin e Ditës së Gruas nga Kryetarja e Kuvendit të Shqipërisë znj. Jozefina Topalli më datën 8 Mars, në pallatin e Kongreseve në Tiranë⁵⁰.

Në takimet elektorale të zhvilluara me të rinj kryesisht të organizuara nga PD, PS dhe LSI, vihet re se një pjesë e mirë e të rinjve që janë pjesë e dekorit janë nën moshën 18 vjeç.

G. MEDIA

Fillimi i fushatës elektorale, edhe pse jo zyrtarisht, po pasqyrohet gjerësisht nga media sidomos ajo elektronike.

Kodi Zgjedhor parashikon qartë mbulimin nga mediat të fushatës zgjedhore, duke përcaktuar në detaje minutazhet falas, reklamat, etj.

⁴⁶ <http://www.balkanweb.com/kryesore/1/malesi-e-madhe-topi-cel-fushaten-politika-sot-behet-restoranteve-118287.html>

⁴⁷ <http://www.mapo.al/2013/01/24/pdiu-prezanton-deputetin-ne-korce/>

⁴⁸ <http://www.shekulli.com.al/web/p.php?id=18358&kat=88>

⁴⁹ “... Të dashur nxënës dhe nxënëse, ...Katër vitet që vijnë do të jenë vitet e cilësisë, të sistemit tonë arsimor...” . Për më shumë shih: <http://www.km.gov.al/?fq=brenda&m=neës&lid=17886>

⁵⁰ “...Unë e di se në zgjedhjet e ardhshme shumica e grave, bashkë me fëmijët e tyre do votojnë për Kryeministrin Sali Berisha. Jam e sigurtë se nënat nuk ia falin atij që e quan veten rilindas, “rilindasit Edvin”, që duke bllokuar votimin e tre ligjeve la vendin pa status, ...”. Për më shumë shih: <http://kryetari.parlament.al/>

Për monitorimin e pasqyrimin të fushatës elektorale nga operatorët mediatikë, KQZ ngre Bordin e Monitorimit të Mediave (BMM).

Afati i ngritjes së Bordit të Monitorimit të Medias nga KQZ është data 13 prill 2013. Ndërkohë në bazë të nenit 84 të Kodit Zgjedhor, KQZ i kërkon përpara datës 23 Janar 2013, Gjykatës së Rrethit Tiranë listën e OJF-ve që veprojnë në fushën e medias dhe që janë rregjistruar të paktën një vit përpara.

Jo më vonë se data 3 Mars KQZ i dërgon OJF të medias kërkesën për të propozuar jo më pak se tre kandidatë brenda datës 3 Prill 2013.

Më pas nga lista e kandidatëve të ofruar çdo anëtar i KQZ-së zgjedh dhe propozon një emër për anëtar të Bordit të Monitorimit të Medias.

H. PJESËMARRJA E GRAVE

Shqipëria vazhdon të mbetet një ndër vendet me nivele të ulëta përfaqësimi të grave.

Në Parlamentin e Shqipërisë ka vetëm 23 deputete gra nga 140 në total ose 16.4%. Në Këshillin e Ministrave vetëm një grua është ministre.

Në Zgjedhjet e fundit Vendore të 8 Majit 2011, në 383 Njësi të Qeverisjes Vendore vetëm 22 gra (ose 5.7%) ishin kandidatë për Kryetare të Nj.Q.V (respektivisht 11 në Bashki dhe 11 në Komuna).

Nga këto vetëm 7 gra arritën të fitonin , 5 në Bashki dhe 2 në Komuna.

Ndërkohë përsa i përket përfaqësimit në Këshillat e Njësive të Qeverisjes Vendore, nga 6600 këshilltarë, vetëm 759 ose 12.2 % janë gra.

Për zgjedhjet vendore 2007 dhe 2011 nëse bëhet një krahasim për përfaqësimin e grave vihet re se ky përfaqësim në 2011 është 50% më pak se në 2007.

E njëjta tendencë vihet re edhe në zgjedhjet parlamentare të këtij vit duke i krahasuar me ato të mëparshmet, nga pikëpamja e garcive dhe detyrimeve ligjore.

Ndonëse rritja e pjesëmarrjes së gruas, përgjatë periudhës së Reformës Elektorale ka qenë kryefjalë e të gjithë aktorëve vendorë të shoqërisë civile dhe organizmave të huaj, në amendimet finale garancitë dhe detyrimet ligjore janë më të vogla se ato të mëparshmet.

Neni 67 pika 6 e Kodit Zgjedhor parashikon se *"Për çdo zonë zgjedhore, të paktën tridhjetë për qind e listës shumëëmërore dhe një në tre emrat e parë të listës shumëëmërore duhet t'i përkasë secilës gjini."*

Sipas nenit 164, nëse një grua deputete dorëhiqet, Kodi siguron që ajo të zëvendësohet me një grua, pavarësisht se kush është në radhë në listën e kandidatëve.

Gjithashtu, në nenin 29 pika 1/ç, Kodi detyron dy partitë e mëdha (PD dhe PS) që në listat e tyre për anëtarë të KZAZ-ve, së paku 30% e listës, në rang vendi të jenë gra.

Në neni 67 parashikohen kërkesat që duhen të plotësojnë listat shumëëmërore të kandidatëve. Pika e fundit e këtij neni i referohet nenit 175 për sanksionet që zbatohen në rast të mos zbatimit të të gjitha kërkesave të nenit 67.

Ndërkohë, neni 175 ka vetëm një dispozitë e cila parashikon sanksione vetëm për mosplotësimin e kuotave të barazisë gjinore.

Në nenin e parë parashikohen sanksionet financiare⁵¹ dhe në të dytin parashikohet sanksioni plotësues për zëvendësimin që mund të kryejë vetë KQZ-ja në listat shumëmemërore të paraqitura, për realizimin e kuotave⁵².

Në këtë situatë lindin dy pikëpyetje:

Së pari, a parashikon kodi masa për mosrealizimin e kërkesave të tjera që përmenden në 5 pikat e tjera të nenit 67, përveç kuotave gjinore?

Së dyti, nëse lista shumëmemërore nuk ka mjaftueshëm emra për të kryer zëvendësimin në përqindjen gjinore që kërkon ligji, si do veprojë KQZ-ja?

Në udhëzimin⁵³ e miratuar prej KQZ-së, për mosplotësim të kërkesave të nenit 67, parashikohet refuzimi prej administratës veçmas kuotës gjinore, për të cilën parashikohet vetëm sanksion financiar.

Amendimet në nenet që kanë të bëjnë me kuotën gjinore, të bëra pa kujdes në teknikën legjislative të ndjekur, në vend që të sillnin më shumë zbatim të kuotave të barazisë gjinore, hoqën edhe ato pak arritje të siguruara deri në atë moment.

K. VËZHguesIT

Neni 6 i Kodit Zgjedhor parashikon vëzhgimin e zgjedhjeve nga vëzhgues vendorë dhe ndërkombëtarë, si dhe nga partitë politike dhe kandidatët e paraqitur nga një grup zgjedhësish.

Çdo subjekt zgjedhor ka të drejtë të emërojë vëzhgues në KZAZ, KQV dhe për çdo tavolinë numërimi në një VNV. Në rast se partitë formojnë koalicion, e drejta e emërimit të vëzhguesve i takon koalicionit dhe jo partive. Çdo koalicion ka të drejtë të propozojë jo më shumë se 3 vëzhgues.

Deri në këto momente s'ka akreditime nga KQZ, si për partitë politike edhe për organizata të ndryshme vendase apo ndërkombëtare që merren me vëzhgimin e procesit zgjedhor.

Ndërkohë, pas ftesës së bërë nga shteti shqiptar, në datat 11-14 Mars 2013, në Shqipëri ishte prezent një mision i OSBE/ODHIR për të vlerësuar nevojën për të patur vëzhgues nga misioni i ODIHR-it në Shqipëri gjatë procesit zgjedhor të 23 Qershorit.

Misioni kreu një sërë takimesh me zyrtarë të lartë të shtetit shqiptar, të partive politike, KQZ-së, medias dhe shoqërisë civile, përfshirë dhe Koalicionin e Vëzhguesve Vendorë.

⁵¹ Neni 175, pika 1 “Mospërmbushja nga ana e subjektit zgjedhor e detyrimeve të parashikuara në pikën 6 të nenit 67 të këtij Kodi, në lidhje me përbërjen e listës, dënohet nga KQZ-ja me gjobë 1 000 000 lekë në rastin e zgjedhjeve për Kuvendin dhe 50 000 lekë në rastin e zgjedhjeve për organet e pushtetit vendor, si dhe sanksionin plotësues, sipas pikës 2 të këtij neni.”

⁵² Neni 175, pika 2 “Kur ndaj një subjekti zgjedhor është konstatuar shkelja, KQZ-ja zbaton si sanksion plotësues zëvendësimin e çdo vakance në listën e subjektit, në zonën ku është konstatuar shkelja, me kandidatët vijues në listë nga gjinia më pak e përfaqësuar deri në plotësimin e kuotës gjinore. Në rast se KQZ-ja vendos aplikimin e këtij sanksioni, përjashtimi i pikës 2 të nenit 164 nuk zbatohet dhe vakanca plotësohet sipas kësaj pike.”

⁵³ Udhëzimi Nr. 2, datë 29.01.2013, “Për caktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidatimit dhe afatet për publikimin e listave të kandidatëve”.

L. ANKESAT DHE APELIMET

Procesi zgjedhor deri në këtë moment, ka krijuar dy precedentë të fortë në dhënien e drejtësisë në çështje zgjedhore. Dy kazuse ligjore, ku dy partitë kryesore Partia Socialiste dhe Partia Demokratike investojnë Kolegjin Zgjedhor dhe Gjykatën Kushtetuese.

1. *Kërkesë padia e Partisë Demokratike në Kolegjin Zgjedhor me objekt caktimin e numrit të Zonave të Administrimit Zonal në rang vendi.*

Në mbledhjen e datës 21.12.2012, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve kishte në rendin e ditës miratimin e ndarjeve të ZAZ-ve. Për shkak se nuk arriti të siguronte një ndarje të numrit të ZAZ-ve që të mbështetej nga votat e 5 komisionerëve, KQZ-ja me Vendimin Nr. 20⁵⁴ mori një qëndrim *omnisioni* duke u tërhequr nga detyrimi për të marrë vendim. Një vendim problematik, që edhe vetë Kolegji Zgjedhor do ta kritikonte më pas.

Ky vendim është ndër të paktat vendime të KQZ-së, ku në radhën e fundit të tij gjendet fraza: “*Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor brenda 5 ditëve nga shpallja e tij*”. Në mënyrë indirekte, KQZ-ja shprehet e pazonja për detyrën e saj dhe i la mundësinë Kolegjit Zgjedhor për t’u investuar.

Më datën 26.12.2013 Partia Demokratike ngriti padi në Kolegjin Zgjedhor me palë të paditur Komisionin Qendror të Zgjedhjeve me këto objekte:

- a. Kundërshtimi i Vendimit të KQZ-së Nr. 20 datë 21.12.2012.
- b. Miratimin e ndarjes së re të Zonave të Administrimit Zgjedhor, për Zgjedhjet për Kuvendin 2013, sipas propozimit të paraqitur nga Partia Demokratike e Shqipërisë në KQZ (100 zona të administrimit zgjedhor)

Më datë 03.01.2013, me vendimin Nr. 1, Kolegji Zgjedhor vendosi:

- a. Pranimin e pjeshëm të padisë.
- b. Shfuqizimin e Vendimit Nr. 20 datë 21.12.2012 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
- c. Miratimin e ndarjes së re të Zonave të Administrimit Zgjedhor për Zgjedhjet për Kuvendin 2013, në 89 (tetëdhjetë e nëntë) Zona të Administrimit Zgjedhor (ZAZ), sipas propozimit të paraqitur nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Në ecurinë e kësaj vendimmarrje vërehen këto problematika:

- a. Pala e paditur, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, kërkoi pranimin e pjeshëm të padisë dhe miratimin e ndarjes së territorit në 89 ZAZ, sipas propozimit të administratës së saj.
Pra, KQZ-ja, pasi ka formalizuar *omnisionin* e saj me një vendim, bie dakord për shfuqizimin e vendimit të nxjerrë nga vetë ajo.
Lë të kuptohet se i padituri (KQZ) bie dakord me paditësin (PD) duke pranuar fajësinë dhe është i ndërgjegjshëm që ka nxjerrë një akt të pavlerë.
- b. Vetë paditësi, Partia Demokratike, në argumentim pohoi *verbatim* se “*vendimi i mësipërm i KQZ-së për mosmiratimin e ndarjes së re të ZAZ-së është marrë në*

⁵⁴ Vendimi Nr. 20, datë 21.12.2012, “*Për mosmiratimin e ndarjes së re të zonave të administrimit zgjedhor për Zgjedhjet për kuvendin 2013*”.

*kundërshtim me ligjin, pasi ky i fundit përcakton si detyrë absolute të vetë KQZ-së, ndarjen e re të zonave zgjedhore dhe jo mos ndarjen*⁵⁵.

Po, në të njëjtën padi, PD i drejtohet Kolegjit Zgjedhor që të bëjë një ndarje të ZAZ-ve, pra që të bëjë një gjykim në themel të çështjes.⁵⁶

- c. Kolegji Zgjedhor, ndonëse i jep të drejtë Partisë Demokratike⁵⁷ se është KQZ-ja që ka tagër për ndarjen e ZAZ-ve, vendos t'i ndajë ajo ZAZ-të.
- d. Kolegji Zgjedhor, për të bërë ndarjen e ZAZ-ve e vlerëson se po bën gjykim në themel, sipas Nenit 158/1/a.
Kritika që i bëhet në këtë rast është se caktimi i ZAZ-ve është hartim dhe miratim akti dhe jo gjykim në themel siç e quan Kolegji. Një gjë të tillë Kodi Zgjedhor nuk e parashikon.
Madje, në këtë rast është e shprehur qartë në Kod se Kolegji Zgjedhor vetëm mund të detyrojë KQZ-në që të marrë vendim.
- e. Kolegji e quan që ka pranuar pjesërisht padinë e PD-së dhe e kryen ndarjen e ZAZ-ve sipas propozimit që ka bërë KQZ-ja.
Ky veprim del jashtë objektivit të padisë, sepse Kolegji Zgjedhor ose mund ta rrëzonte ose ta miratonte propozimin e PD-së, dhe jo të miratonte propozimin e të paditurit (KQZ-së).

2. Kërkesë padi e Partisë Socialiste dhe e një grupi deputetësh të kësaj partie në Gjykatën Kushtetuese me objekt caktimin e mandateve në bazë qarqesh.

Kodi Zgjedhor parashikon në pikën 2 të Nenit 76 se KQZ duhet të bëjë llogaritjen dhe përcaktimin e mandateve jo më vonë se 15 ditë nga marrja e të dhënave. Duke qenë se të dhënat në KQZ janë dorëzuar më 9 Nëntor 2012, afati është ezauruar më datën 24 Nëntor 2012.

KQZ-ja jo vetëm që u tregua e pazonja të plotësonte kriterin kohë të këtij detyrimi, por u dorëhoq prej tij me argumentimin *“mungesa e numrit të kërkuar ligjërisht të votave “pro” sjell si pasojë, që projekt-akti i paraqitur “Për caktimin e numrit të mandateve për çdo zonë zgjedhore të zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë të vitit 2013”, të mos miratohet.*⁵⁸

Por, Kodi Zgjedhor lë një shteg sigurie në rast eventual. Ndonëse në pikën dy të Nenit 76 kërkon një procedurë të përsheptuar të Kuvendit për miratim, në pikën tre të po këtij neni Kodi Zgjedhor përcakton se për çdo rast afati maksimal i përcaktuar për miratimin e mandateve është deri në 6 muaj para fundit të mandatit të Kuvendit, pra deri më datën 7 Mars 2013.

Në këtë pikë shihet një indulgjencë e vetë Kodit Zgjedhor përsa i përket afateve, duke qenë se i jep kohë Kuvendit për finalizimin e procesit, rrjedhimisht i jep kohë edhe

⁵⁵ Vendimi Nr. 1, faqe 2 i Kolegjit Zgjedhor, datë 03.01.2013.

⁵⁶ Neni 158, pika 1, gërma b. *“Kolegji Zgjedhor mund të vendosë gjykimin e çështjes në themel.”*

⁵⁷ Vendimi Nr. 1, faqe 6 i Kolegjit Zgjedhor, datë 03.01.2013: *“Është e qartë se në zbatim të ligjit është detyrë e KQZ-së caktimi i numrit të ZAZ-ve, por në mungesë të formalizimit të vullnetit të KQZ-së për shkak të kuorumit të kërkuar prej 5 votash, me të drejtë propozimi që nuk është miratuar, ka marrë trajtën e vendimit, sikundër rezulton jo vetëm nga akti i zbardhur, por edhe nga procesverbali i mbajtur në KQZ, në faqen 118 të cilit pasqyrohet se nuk miratohet akti! Vendimi N.20.”*

⁵⁸ Vendimi Nr. 15, datë 23.11.2012, *“Për caktimin e numrit të mandateve për çdo zonë zgjedhore të zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë të vitit 2013”.*

hallkave të mëparshme siç është Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve, të ezaurojnë kompetencën dhe detyrimin e tyre, pavarësisht afateve të kaluara e të shkelura tashmë.

KVV-ja bëri thirrje publike, që KQZ-ja si një organ kolegjal, në kushtet e mospërbushjes së detyrimeve ligjore dhe detyrimit madhor kushtetues për caktimin e mandateve, i kishte të gjitha tagrat për të marrë në shqyrtim sërish çështjen e përcaktimit të mandateve, madje duke ribërë ndarjen e mandateve mbi bazën e numrit të popullsisë në periudhën e atëhershme.

Kjo do të maksimizonte akoma më shumë përmbushjen e detyrimit kushtetues mbi barazinë e votës, pasi në përlllogaritjet e atëhershme të ndarjes së mandateve do të reflektoheshin edhe lëvizjet e mundshme të popullsisë që mund të jenë bërë pas datës 7 Nëntor e deri në periudhën kur do të merrej në rishqyrtim çështja.

Çështja e përcaktimit të mandateve do të shkonte për zgjidhje në Kuvend.

Koalicioni i Vëzhguesve Vendorë, i ftuar më datën 23 Janar 2013 për të dhënë qëndrimin e tij në Komisionin e Ligjeve, shprehu qëndrimin e tij për mosinvestimin e Kuvendit në këtë proces, por gjithsesi komisioni me shumicë votash të deputetëve të maxhorancës vendosi kalimin në seancë plenare.

Në datën 31.01.2013, me 72 vota pro dhe 63 vota kundër, Kuvendi miratoi ndarjen e mandateve sipas qarqeve të vitit 2009.

Partia Socialiste dhe një grup deputetësh i kësaj partie ngritën padi në Gjykatën Kushtetuese me këto objekte:

- a. Shfuqizimi si antikushtetues i Vendimit të Kuvendit të Shqipërisë nr.2/2013, datë 31.01.2013 “*Për caktimin e numrit të mandateve në çdo zonë zgjedhore të zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë të vitit 2013*”.
- b. Pezullimin e zbatimit të Vendimit të Kuvendit të Shqipërisë nr.2/2013, datë 31.01.2013 “*Për caktimin e numrit të mandateve në çdo zonë zgjedhore të zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë të vitit 2013*”.

Më datën 8 mars 2013 Gjykata Kushtetuese e rrëzoi padinë e bërë nga Partia Socialiste.

IV. REKOMANDIME

- KQZ

- KQZ duhet të angazhohet për të funksionuar me një frymë kolegjaliteti.
- Anëtarët e KQZ-së duhet të bashkëpunojnë ngushtë me njëri-tjetrin dhe në punën e tyre të udhëhiqen vetëm nga ligji.
- KQZ duhet të respektojë me rigorozitet afatet e parashikuara në Kodin Zgjedhor dhe të ushtrojë autoritetin e saj për të ndikuar në zbatimin me rigorozitet të ligjit edhe nga institucione të tjera që marrin pjesë në ndërtimin e infrastrukturës zgjedhore.
- KQZ duhet të miratojë sa më parë rregulloren për funksionimin dhe organizimin e KQZ-së, ku duhet të përfshijë midis të tjerash edhe marrëdhëniet me administratën, apo aspekte të tjera të funksionimit të KQZ-së.
- KQZ duhet të marrë sa më parë të gjitha masat e nevojshme për funksionalitetin e dy teknologjive të reja SEV dhe SEN.
- KQZ duhet të bëjë transparencën e nevojshme dhe të informojë opinionin publik dhe aktorët e interesuar në lidhje me zbatimin e teknologjisë SEV.
- KQZ duhet verifikojë sa më parë dokumentacionin përkatës të kandidatëve për anëtar të KZAZ-ve. Të sigurojë plotësimin e kuotës gjinore për kandidatët e dy partive të mëdha.
- KQZ duhet të miratojë sa më parë manualin dhe materialet e tjera të nevojshme për nisjen e trajnimeve të anëtarëve të KZAZ-ve.
- KQZ duhet t'i kushtojë mjaft rëndësi trajnimit të komisionerëve të KZAZ-ve si personat kyç për administrimin e zgjedhjeve në nivel lokal.
- KQZ duhet parashikojë edhe trajnimin e anëtarëve të Bordit të Monitorimit të Medias, në veçanti në lidhje me aftësitë e tyre për të gjykuar mbi zbatimin e ligjit zgjedhor nga mediat.
- Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve duhet të ndjekë me më shumë vëmendje të gjithë procesin e përgatitjes së listave të zgjedhësve. Raportet e auditeve teknicienë duhet të përdoren me efikasitet nga KQZ për të përmirësuar në maksimum procesin e saktësimin të listave.
- KQZ duhet të orientojë auditët teknicienë për mënyrat e raportimit në mënyrë që të krijojë një gjykim të drejtë mbi raportet që i paraqiten.

- MINISTRISË SË BRENDSHME

- Të shfrytëzojë të gjitha hapësirat ligjore për të hartuar një udhëzim tjetër me synim njoftimin e zgjedhësve. Në vazhdim t'u lëvrojë të gjitha NJQV-ve fondin përkatës për njoftimin e zgjedhësve.
- Të pajisë sa më parë zyrat e gjendjes civile pranë Njësive të Qeverisjes Vendore me bazën materiale të nevojshme.
- T'i japë zgjidhje problemit të zgjedhësve pa adresë vendbanimi dhe t'i udhëzojë NJQV-të se si duhet të veprojnë me këto lista.
- Ministria e Brendshme duhet të fillojë sa më shpejt fushatën publicitare për të informuar zgjedhësit për kontrollin e emrit të tyre nëpër lista si edhe procedurën që duhet të ndjekin ata në raste problematike.

- KËSHILLIT TË MINISTRAVE

- Të marrë në shqyrtim dhe të lehtësojë problemin e pajisjes me karta identiteti të rinjve që votojnë për herë të parë, si dhe të atyre personave që nuk janë pajisur ndonjëherë me kartë identiteti, në mënyrë që askush të mos privohet nga e drejta për të votuar.

- PARTITË POLITIKE

- Partitë Politike duhet të heqin menjëherë dorë nga zhvillimi i paligjshëm i fushatës në zbatim të Kodit Zgjedhor. Ato duhet ta fillojë atë në datën 23 Maj 2013 sikundër sanksionohet në Kod.
- Partitë politike duhet të angazhohen për ndërmarrjen e hapave konkrete për rritjen e besimit mes palëve për të realizuar një proces me sa më shumë standarte në të mirë të vendit dhe qytetarëve shqiptarë.
- Partitë Politike duhet shmangin ushtrimin e presionit ndaj KQZ-së dhe administratës zgjedhore në varësi, qoftë edhe në nivelin e deklaratave publike.
- Partitë politike duhet të angazhohen në mospërdorimin e burimeve njerëzore dhe materiale, të administratës publike në nivel qendror e lokal, të mospërdorimit të aseteve dhe fondeve publike, për qëllime elektorale, përveçse në përputhje me dispozitat e kodit zgjedhor.
- Partitë politike duhet të angazhohen në mospërdorimin si dekor, si pjesëmarrës apo si aktivist të fëmijëve në të gjitha aktivitetet, apo takimet e tyre.

- Partitë politike duhet të angazhohen për të zbatuar maksimalisht kuotat gjinore të parashikuara.
- Partitë politike duhet të përgatiten për një fushatë zgjedhore të qetë, me etikë të lartë, ku të dominojnë përballja e platformave dhe programeve në të mirë dhe interes të qytetarit, si dhe të përgatiten për t'i servirur qytetarit premtime të vërteta, vizionare dhe të realizueshme.
- Partitë Politike duhet të angazhohen e të jenë të gatshme për nënshkrimin e Kodit të Etikës dhe të Sjelljes së Mirë përgjatë fushatës elektorale.

- MEDIA

- Media elektronike dhe ajo e shkruar duhet t'i shërbejnë misionit të informimit me vërtetësi dhe objektivitet të qytetarit, larg interesave politike.
- Televizionit Publik Shtetëror i bëjmë thirrje të jetë një media e pavaruar që transmeton me përgjeshmëri, paanësi dhe objektivitet si një televizion i të gjithë qytetarëve.

- NJESITË E QEVERISJES VENDORE

- Të ushtrojnë të gjithë autoritetin dhe burimet e tyre për një proces sa më të arrirë të saktësimin të listave zgjedhore.
- Të bëjnë ç'është e mundur për të njoftuar zgjedhësit nëse janë apo jo pjesë e listave zgjedhore paraprake.
- Të shpallin listat e zgjedhësve në ambiente pranë zyrave të gjendjes civile, në ambiente të hapura dhe me akses të lirë në çdo kohë për qytetarët.
- Të gjitha njësitë e qeverisjes vendore të marrin masat e nevojshme për t'u krijuar kushtet e përshtatshme për të votuar personave me aftësi të kufizuara. Ato duhet të kenë informacion mbi numrin dhe vendndodhjen e kwtire personave nw mwnyrw qw t'ia kalojnë kwtw informacion KQZ-sw.
- Gjithashtu, Njësitë e Qeverisjes Vendore duhet të kenë kujdes për regjistrimin e komunitetit rom në listat e zgjedhësve.

POLICIA E SHTETIT

- Koalicioni i Vëzhguesve Vendorë vlerëson kontributin dhe qëndrimin profesional të policisë së shtetit në proceset e fundit zgjedhore.

Koalicioni nxit Policinë e shtetit që edhe në këto zgjedhje roli dhe sjellja e forcave të rendit të jetë në përmbushje të detyrimeve ligjore për të siguruar mbarëvajtjen e fushatës zgjedhore dhe gjithë etapat e tjera të procesit zgjedhor.

SHTOJCA

**QËNDRIMET PUBLIKE TË KOALICIONIT
PËR ÇËSHTJE TË CAKTUARA TË SHPREHURA NËPËRMJET
DEKLARATAVE DHE LETRAVE TË HAPURA**

ANEKS I

LETËR E HAPUR

Drejtuar:

Znj. Jozefina TOPALLI, Kryetare e Kuvendit të Shqipërisë

Z. Astrit PATOZI, Kryetar i Grupit Parlamentar të PD

Z. Gramoz RUÇI, Kryetar i Grupit Parlamentar të PS

Z. Lefter KOKA, Kryetar i Grupit Parlamentar të LSI

Anëtarëve të Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut në Kuvendin e Shqipërisë

Z. Sali BERISHA, Kryetar i Partisë Demokratike

Z. Edi RAMA, Kryetar i Partisë Socialiste

Z. Ilir META, Kryetar i LSI

Z. Shpëtim IDRIZI, Kryetar i PDIU

Z. Vangjel DULE, Kryetar i PBDNJ

Z. Fatmir MEDIU, Kryetar i PR

Për dijeni:

Partive Politike në Republikën e Shqipërisë

Misionit të OSBE / ODHIR

Delegacionit të Bashkimit Europian

Zyrës së Këshillit të Europës

Ambasadës së Shteteve të Bashkuara

E nderuar znj. Kryetare e Parlamentit!

Të nderuar Kryetarë të Grupeve Parlamentare të Kuvendit të Shqipërisë!

Të nderuar Kryetarë të Partive Politike Parlamentare !

Koalicioni i Vëzhguesve Vendorë (KVV) një prej grupimeve më të mëdhenj të vëzhguesve vendorë që ka ndjekur zhvillimin e procesve zgjedhore në vend që prej vitit 2005 (si KVV), ju shpreh vlerësimin e tij për angazhimin dhe vullnetin e treguar në miratimin me konsensus të ndryshimeve në Kodin Zgjedhor.

Duke sjellë në vëmendje tuaj, se përkushtimi dhe fryma e bashkëpunimit midis jush dhe përkushtimi ndaj zbatimit me korrektësi të ligjit është e vetmja mënyrë për zhvillimin e një procesi zgjedhor ligjor, demokratik, të drejtë dhe të ndershëm,

Koalicioni konstaton se pikërisht fillimi i procesit zgjedhor të ardhshëm me rindërtimin e Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve, sipas afateve të përcaktuar në ligjin e miratuar bashkarisht, është çënuar duke shënuar një precedent aspak pozitiv në lidhje me respektimin dhe zbatimin e ligjit në vijimësi.

Nga informacionet e marra, edhe në mbledhjen e djeshme të datës 17 shtator të Konferencës së Kryetarëve të Kuvendit të Shqipërisë, ende nuk ka asnjë datë të përcaktuar për futjen në rendin e ditës së miratimit të 6 anëtarëve të rinj të KQZ-së.

Duke vlerësuar prononcimet publike të partive politike në lidhje me domosdoshmërinë e respektimit të ligjit në gërmë dhe në frymë, **Koalicioni vëren me shqetësim se nuk është marrë asnjë hap institucional apo publik nga partitë politike parlamentare në lidhje me propozimet e tyre për gjashtë anëtarët e KQZ-së, ndërkohë që ky proces duhet të ishte mbyllur më datën 15 Shtator 2012⁵⁹.**

Pavarësisht se zgjedhja e anëtarëve të rinj të KQZ-së është një kompetencë ekskluzive e Partive Politike, **Koalicioni në frymën e ligjit në lidhje me pavarësinë dhe integritetin e tyre si edhe me synim rritjen e transparencës dhe të besimit të publikut, i sugjeron partive politike që të shpallin sa më parë kandidaturat e tyre si dhe të bëjnë publik vlerësimin e tyre në lidhje me integritetin dhe aftësitë e këtyre kandidaturave në përmbushje të detyrës si administrator të lartë të zgjedhjeve, në mënyrë të pavaruar, të paanshme dhe vetëm në zbatim të ligjit.**

Përsa i përket Kryetarit të Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve, Koalicioni e konsideron procedurën e zgjedhjes së tij dhe sidomos heqjen e së drejtës së partive politike për të propozuar kandidatura, **si një mundësi mjaft të mirë për të vënë në rrugën e duhur depolitizimin dhe funksionimin në mënyrë të paanshme dhe jo partizane të KQZ-së.**

Në lidhje me këtë proces, Koalicioni i sugjeron Kuvendit të Shqipërisë që të bëjë **sa më transparent dhe sa më jopolitik procesin e përzgjedhjes së Kryetarit të ardhshëm të KQZ-së.**

Në këtë frymë, Koalicioni i sugjeron Kuvendit që të bëjë publike të gjitha kandidaturat e paraqitur në sekretarinë e Kuvendit si dhe të organizojë një proces sa më të drejtë, konkurrent dhe aspak të ndikuar nga anësitë partiake.

Për të rritur integritetin e procesit dhe besimin ndaj tij, **Koalicioni sugjeron organizimin e seancave publike dëgjimore me të gjithë kandidatët e paraqitur që plotësojnë kriteret ligjore të parashikuara⁶⁰.**

Gjithashtu, **Koalicioni i sugjeron Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, si organi që përzgjedh dhe i propozon Kuvendit kandidaturat finale për Kryetar të KQZ-së, që në frymën dhe në zbatim të ligjit të miratojë dhe të bëjë publike paraprakisht kriteret mbi të cilat do të organizohen seancat publike dhe mbi të cilat do të bëhet vlerësimi i kandidatëve, si vizioni,**

⁵⁹ Ligji nr. 74/2012 datë 19.07.2012 (i dekretuar nga Presidenti i Republikës më datën 16.08.2012) “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10 019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë””: Neni 181 “Zgjedhja e anëtarëve të KQZ-së”, pika 1 “Kuvendi, 30 ditë nga data e shpalljes së këtij ligji, zgjedh anëtarët e KQZ-së, sipas neneve 14 dhe 15 të këtij Kodi”.

⁶⁰ Neni 181/2, Neni 15/2 dhe Neni 12/2 i Ligjit nr.10 019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar: “Kandidat për Kryetar të KQZ-së duhet:

a) të jetë me moshë mbi 35 vjeç;

b) të jetë me arsim të lartë;

c) të ketë përvojë profesionale prej jo më pak se 10 vjet punë, të paktën në një nga fushat e mëposhtme:

i) në fushën e së drejtës;

ii) në administratën publike;

iii) në administrimin e zgjedhjeve;

iv) si drejtues i organizatave jofitimprurëse, të cilat kanë objekt të veprimtarisë së tyre mbrojtjen dhe zhvillimin e lirive dhe të drejtave të njeriut, zhvillimin e zgjedhjeve demokratike apo politikat publike;

ç) të mos jetë i dënuar penalisht;

d) të mos ketë qenë anëtar i ndonjë partie politike në 5 vitet e fundit;

dh) të mos ketë qenë i zgjedhur deputet i Kuvendit në 5 vitet e fundit;

e) të mos ketë qenë pjesëtar në 5 vitet e fundit në Policinë e Shtetit, në Forcat të Armatosura dhe në Shërbimin Informativ Shtetëror;

ë) të mos jetë larguar nga administrata publike apo çdo funksion publik për shkelje të detyrës.

eksperienca, apo çështje të tjera që lidhen direkt apo indirekt me administrimin e një procesi zgjedhor konform standarteve dhe aspiratave demokratike të shoqërisë dhe shtetit shqiptar.

Në të kundërt, një votim tërësisht politik, partiak dhe i paargumentuar mbi kritere të qarta e vizionare, do të delegjitimojë në thelb qëndrimet publike të partive politike në lidhje me standartet e realizimit të procesit zgjedhor, si dhe do të shuajë shpresën e rradhës për mundësinë e përfshirjes të kontributeve jashtë politikës në ndërtimin dhe konsolidimin e institucioneve të pavaruara.

Për Koalicionin e Vëzhguesve Vendorë

**Shoqata për Kulturë
Demokratike**

**Gerta META
Drejtoresh Ekzekutive**

KRIIK Albania

**Premto GOGO
Kryetar**

**Shoqata për Gratë
dhe Fëmijët**

**Rajmonda PRIFTI
Drejtoresh Ekzekutive**

Tiranë, më 18 Shtator 2012!

ANEKS II**DEKLARATË****Mbledhja sa më parë e KQZ-së dhe Dekretimi i Datës së Zgjedhjeve, të domosdoshme për përmbushjen e standarteve të procesit të ardhshëm zgjedhor**

Koalicioni i Vëzhguesve Vendorë (KVV) duke vlerësuar zgjedhjen e anëtarëve të Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve dhe duke iu uruar sukses në përmbushjen e detyrës së tyre, iu bën thirrje që të mblidhen sa më parë për t'i paraprirë në kohë detyrimeve dhe afateve që parashikon ligji zgjedhor.

Koalicioni tërheq vemëndjen në veçanti në lidhje me marrjen sa më parë të masave për realizimin e teknologjisë së re informative në Zgjedhjet për Kuvendin të vitit 2013, të cilat sipas afateve të përcaktuara në Kodin Zgjedhor duhet të kishin filluar jo me vonë se në datën 1 Tetor 2012⁶¹.

Gjithashtu, duke synuar realizimin e një procesi zgjedhor sa më të arrirë, Koalicioni i **bën thirrje Presidentit të Republikës z. Bujar Nishani, që në zbatim të Nenit 9 të Kodit Zgjedhor, të marrë në shqyrtim dhe të dekretojë sa më parë datën e Zgjedhjeve të Ardhsme Parlamentare.**

Pavarësisht limitit të parashikuar nga ligji i cili është data 7 Dhjetor 2012, dekretimi sa më parë i datës së zgjedhjeve do të sigurojë kohë të mjaftueshme në dispozicion të institucioneve përkatëse për nisjen e një sërë processh të rëndësishme të ndërtimit të infrastrukturës zgjedhore si: përgatitja e listës së zgjedhësve⁶², caktimi dhe shpërndarja e Qendrave të Votimit (neni 62/5), miratimi i anëtarëve të Kolegjit Zgjedhor⁶³, etj, afatet e nisjes së të cilave kushtëzohen nga dekretimi i datës së zgjedhjeve.

Tiranë, më 23 Tetor 2012!

⁶¹ Neni 179 pika 1 e Ligjit Nr. 10 019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar me Ligjin Nr. 74/2012 datë 19.07.2012: “1. **Jo më vonë se 30 ditë nga hyrja në fuqi e këtij ligji**, KQZ-ja fillon përgatitjen e projektit për ngritjen e sistemit të verifikimit dhe regjistrimit të zgjedhësve (SEV) dhe sistemit elektronik të numërimit (SEN). Në përgatitjen e projektit të SEV-it përfshihen edhe përfaqësues të Ministrisë së Brendshme.

⁶² Neni 51 i Kodit Zgjedhor: “Publikimi i ekstraktit të përbërësve zgjedhorë”, pika 1: “Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Civile, **jo më vonë se 5 ditë nga dita e dekretimit të datës së zgjedhjeve**, urdhëron zyrat e gjendjes civile të fillojnë procesin e hartimit të ekstraktit të përbërësve zgjedhorë, në përputhje me këtë Kod. Jo më vonë 15 ditë nga dita e dekretimit, zyra e gjendjes civile nxjerr në format elektronik ekstraktin me përbërësit zgjedhorë të të gjithë shtetasve me të drejtë vote në datën e zgjedhjeve, me përjashtim të shtetasve që kanë mbushur 100 vjeç deri në këtë datë.”

⁶³ Neni 146 i Kodit Zgjedhor: “Përbërja e Kolegjit Zgjedhor të Gjykatës së Apelit, Tiranë”, pika 3: “Shorti për përzgjedhjen e tetë gjyqtarëve të Kolegjit Zgjedhor të Gjykatës së Apelit, Tiranë **hidhet jo më vonë se 5 ditë pas dekretimit të datës së zgjedhjeve** për Kuvendin”.

ANEKS III

DEKLARATË

Standartet e procesit të ardhshëm zgjedhor në pikëpyetje nga moszbatimi dhe mosrespektimi i afateve të parashikuara në Kodin Zgjedhor

Koalicioni i Vëzhguesve Vendorë (KVV) në vazhdimësi të punës së tij në monitorimin e përgatitjes së procesit të ardhshëm zgjedhor, shpreh shqetësimin në lidhje me performancën e administratës zgjedhore dhe mos respektimin e një sërë afatesh të parashikuara në Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.

Koalicioni mbështet fort dhe nxit anëtarët e Komisioni Qëndror të Zgjedhjeve që në punën e tyre t'u bëjnë ballë presioneve dhe influencave të partive politike, si dhe të gjejnë forcën e nevojshme për të bashkëpunuar me njëri-tjetrin për një funksionim normal dhe kolegjal të institucionit më të lartë zgjedhor, duke u udhëhequr vetëm nga zbatimi me korrektësi i ligjit në përmbushje të detyrave dhe afateve të parashikuara për ndërtimin e infrastrukturës së nevojshme zgjedhore.

Në lidhje me ecurinë e deritanishme Koalicioni tërheq vëmendjen në lidhje me:

I - Vendimmarrjen e Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve

Koalicioni shpreh keqardhjen për shkeljen e afateve të parashikuara dhe mosmiratimin ende nga KQZ të ndarjes së mandateve për çdo zonë zgjedhore si dhe për mosmiratimin e numrit të Zonave Zgjedhore⁶⁴, si dy nga vendimmarrjet më të rëndësishme për procesin zgjedhor.

Për më tepër, pamundësinë e marrjes së vendimeve me shumicë të cilësuar nga KQZ dhe zëvendësimin e kësaj vendimmarrje nga Kolegji Zgjedhor, Koalicioni e konsideron si një precedent të rrezikshëm për ecurinë e mëtejshme të përgatitjes së procesit zgjedhor e në veçanti të miratimit të akteve me karakter normativ dhe që kanë për qëllim rregullimin e çështjeve që lidhen me zgjedhjet, për të cilat duhet shumicë e cilësuar aprovimi me jo më pak se 5 vota të anëtarëve të KQZ-së.

Partitë Politike duhet të gjejnë vullnetin për të bashkëpunuar dhe hequr dorë nga interesat e ngushta të tyre, duke kujtuar se pavarësisht se anëtarët e KQZ-së janë propozuar prej tyre, ata duhet të ushtrojnë funksionin e tyre në mënyrë të pavarur dhe ta pandikuar nga influencat apo lojërat politike.

Koalicioni nxit partitë politike të gjejnë vullnetin dhe gjuhën e përbashkët për çështje që ata i gjykojnë të rëndësishme jashtë institucionit të KQZ-së, duke e lenë këtë të fundit të punojë në mënyrë të pandikuar, të pavaruar dhe profesionale.

Koalicioni u kujton Partive Politike që në raportet e Vëzhguesve Ndërkombëtarë dhe atyre Vendas është vënë theksi tek mos-politizimi i punës dhe i funksionimit të KQZ-së si një nga elementët kryesorë të përmbushjes së standarteve, ndaj i fton ata të ushtrojnë të gjitha aftësitë e tyre për të ndihmuar në funksionimin normal dhe vendimmarrjen e përbashkët e kolegjinë të KQZ-së.

⁶⁴ Neni 27, pika 5 e Ligjit Nr. 10 019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar me Ligjin Nr. 74/2012 datë 19.07.2012: "5. Zonat e Administrimit Zgjedhor miratohen nga KQZ-ja **jo më vonë se 9 muaj para përfundimit të mandatit të Kuvendit**, mbi bazën e numrit të shtetasve me të drejtë vote në datën e fundit të periudhës zgjedhore për caktimin e zgjedhjeve, sipas të dhënave të Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile."

Ky vendim duhet të ishte marrë **jo më vonë se data 7 Dhjetor 2012**.

II - Performancën e Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve dhe të administratës së tij

Koalicioni i tërheq vëmendjen Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve për një performancë sa më profesionale të tij dhe të administratës së KQZ-së, në përmbushje të detyrimeve dhe afateve të përcaktuara në Kodin Zgjedhor.

Për një funksionim sa më normal e të plotë, Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve **duhet të miratojë sa më parë Rregulloren për Organizimin dhe Funksionimin e KQZ-së**⁶⁵, afati për miratimin e së cilës ishte data 26 Dhjetor 2012.

Sërish, Koalicioni tërheq vëmendjen në lidhje me marrjen sa më parë të masave për **realizimin e teknologjisë së re informative** në Zgjedhjet për Kuvendin të vitit 2013, të cilat sipas afateve të përcaktuara në Kodin Zgjedhor janë tejkaluar e shkelur në mënyrë flagrante, madje deri tani nuk ka asnjë vendimarrje në lidhje me këtë proces shumë të rëndësishëm.

Koalicioni thekson, se suksesi i zbatimit të teknologjisë së re informative, pavarësisht se nuk ka impakt të drejtëpërdrejtë në rezultatin e procesit të ardhshëm zgjedhor, është një test shumë i rëndësishëm për aplikimin ose jo të kësaj teknologjie në të gjithë vendin në zgjedhjet e rradhës të vitit 2015.

Duke vlerësuar maksimalisht rëndësinë e procesit të **hartimit të listave të zgjedhësve si dhe rëndësine e transparencës së plotë** që duhet të ketë ky proces, Koalicioni i bën thirrje KQZ-së që të nisë sa më parë mbikqyrjen e hartimit të këtyre listave sikundër parashikohet në nenin 61 të Kodit Zgjedhor, madje e konsideron të vonuar këtë proces.

KQZ duhet të miratojë sa më parë aktin normativ për rregullimin e veprimtarisë së auditëve teknikienë për listën e zgjedhësve dhe SEV (Sistemin Elektronik të Verifikimit) si dhe të marrë sa më parë vendim për emërimin e këtyre dy auditëve teknikienë brenda afatit të parashikuar të 3 Janarit 2013⁶⁶.

Në përfundim Koalicioni inkurajon Komisionin Qëndror të Zgjedhjeve të kërkojë mbështetjen e të gjithë aktorëve institucionalë për të përmbushur në mënyrë të plotë të gjitha detyrimet e kërkuara në zbatim të ligjit, për zhvillimin e një procesi zgjedhor ligjor, të drejtë e të ndershëm.

Tiranë, më 27 Dhjetor 2012!

⁶⁵ Neni 184, pika 2 e Ligjit Nr. 10 019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar me Ligjin Nr. 74/2012 datë 19.07.2012: “2. **Jo më vonë se 60 ditë nga mbledhja e parë**, KQZ-ja e zgjedhur pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, miraton Rregulloren e KQZ-së, e cila përfshin edhe marrëdhëniet e anëtarëve të saj me administratën e KQZ-së”.

Miratimi duhet të ishte bërë **jo më vonë se më 26 Dhjetor 2012**.

⁶⁶ Neni 61 “Mbikqyrja e hartimit të listave të zgjedhësve nga KQZ”, pika 1, 2 dhe 3 e Ligjit Nr. 10 019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar me Ligjin Nr. 74/2012 datë 19.07.2012: “1. KQZ-ja mbikëqyr procesin e hartimit të listave, duke i kërkuar informacion Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile dhe njërive të qeverisjes vendore për procesin e caktimit të zonave të qendrave të votimit dhe numrit të zgjedhësve për çdo qendër votimi, në përputhje me rregullat e këtij Kodi dhe ligjit të gjendjes civile.

2. KQZ-ja, **jo më vonë se 30 ditë nga dekretimi i zgjedhjeve, emëron me vendim dy auditë teknikienë** për verifikimin e veprimeve në bazën e të dhënave të RKGJC-së. Të drejtën e propozimit për secilin audit teknikien e kanë respektivisht Kryetari dhe Zëvendëskryetari i KQZ-së, pas konsultimit me përfaqësuesit e partisë më të madhe të shumicës dhe asaj më të madhe të pakicës në KQZ. Auditët teknikienë nuk mund të shkarkohen nga detyra, përveç shkeljeve të përcaktuara në pikën 9 të këtij neni. Auditë teknikienë zëvendësues emërohet jo më vonë se 5 ditë sipas të njëjtës procedurë dhe kriter të përcaktuar në këtë nen.

3. Auditët teknikienë duhet të kenë arsimim universitar dhe ekspertizë në fushën e teknologjisë së informacionit apo statistikës, si dhe të kenë njohuri për procesin e hartimit të listave të zgjedhësve dhe/ose gjendjes civile. **Rregullat e veçanta për kushtet e kontratës dhe për kryerjen e auditimit, përcaktohen me akt normativ të KQZ-së.”**

ANEKS IV

DEKLARATË

Listat paraprake të zgjedhësve ende të pasakta e të papublikuara

Lista e Zgjedhësve, si një mjet që sanksionon të drejtën e qytetarëve për të shprehur vullnetin e tyre, përbën një ndër elementët më thelbësor të ndërtimit dhe realizimit të një procesi zgjedhor ligjor, të drejtë dhe të ndershëm.

Koalicioni i Vëzhguesve Vendorë (KVV) konstaton se procesi i përgatitjes dhe publikimit të listave paraprake të zgjedhësve, më saktësisht, i ekstraktit të parë të përbërësve zgjedhorë të të gjithë zgjedhësve, sipas vendbanimit dhe qendrave të votimit, është cënuar nga mosrespektimi i afateve ligjore të parashikuara dhe moszbatimi i dispozitave ligjore të përcaktuara.

Sipas dispozitave ligjore të parashikuara në Kodin Zgjedhor⁶⁷ si dhe në udhëzimin nr. 374 datë 10.12.2012 të Ministrisë së Brendshme⁶⁸, të gjitha njësitë vendore duhet që brenda datës 3 Janar 2013 të kishin përgatitur, printuar dhe publikuar në ambientet e Zyrave të Gjendjes Civile, ose në ambientet pranë tyre me akses të lirë për publikun, ekstratin e parë të përbërësve zgjedhorë të të gjithë zgjedhësve⁶⁹.

Koalicioni ngre shqetësimin për ndjeshmërinë e pakët ndaj zbatimit me korrektësi të ligjit që vërehet në një pjesë të madhe të zyrtarëve të Njësive të Qeverisjes Vendore, madje disa prej tyre nuk janë në dijeni të detyrimit ligjor, apo kanë informacion të gabuar mbi dispozitat që përcaktojnë afatet apo mënyrat e publikimit të listave paraprake të zgjedhësve.⁷⁰

Një pjesë e Njësive të Qeverisjes Vendore ende janë duke punuar për riformatimin e qendrave të votimit sipas kërkesave të reja të Kodit Zgjedhor, i cili parashikon shkrirjen

⁶⁷ Neni 51, pika 4 e Ligjit Nr. 10 019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar me Ligjin Nr. 74/2012 datë 19.07.2012: “4. **Jo më vonë se 30 ditë nga dekretimi i datës së zgjedhjeve, zyrat e gjendjes civile**, pas miratimit nga kryetari i njësisë vendore, printojnë dhe publikojnë ekstraktin e përbërësve zgjedhorë të të gjithë shtetasve që kanë vendbanim në zonat e qendrave të votimit nën juridiksionin e çdo zyre. Publikimi bëhet në ambientet e zyrave të gjendjes civile ose në ambientet pranë tyre me akses të lirë për publikun.

⁶⁸ Pika 12 e Udhëzimit Nr. 374, datë 10.12.2012 “Për procedurat e hartimit të listave të zgjedhësve për zgjedhjet për Kuvendin”: “12. **Zyrat e gjendjes civile në bashki/komuna/njësi bashkiake, brenda datës 3 janar 2013, printojnë dhe publikojnë**, pasi të firmoset nga kryetari përkatës, ekstraktin e parë të përbërësve zgjedhorë të të gjithë zgjedhësve, sipas vendbanimit dhe qendrave të votimit, nën juridiksionin e tyre territorial. Ekstrakti i përbërësve zgjedhorë, me të njëjtat kritere, do të printohet dhe publikohet edhe çdo 30 ditë sipas përcaktimit të Kodit Zgjedhor. DPGJC-ja publikon këto ekstrakte në shkallë vendi, në faqen e saj zyrtare, si dhe ia dërgon KQZ-së për publikim në faqen e saj zyrtare.

⁶⁹ Nga monitorimi i kryer deri më tani rezulton se vetëm pak njësi vendore i kanë publikuar listat paraprake të plota (psh. Njësia Bashkiake Nr. 3 - Tiranë, Bashkia e Këlcyrës - Përmet, Bashkia Burrel, etj); disa i kanë publikuar ato pjesërisht dhe po punojnë për ndreqjen e gabimeve në pjesën tjetër të listave (psh. Njësia Bashkiake Nr. 4, Nr. 7 dhe Nr. 11 – Tiranë, etj); ndërkohë që ka edhe njësi të cilat i kanë publikuar listat të shpërndara në vende publike pranë qendrave të mundshme të votimit, dhe jo pranë zyrës së gjendjes civile sikundër parashikohet në ligj (psh. Njësia Bashkiake Nr. 11 – Tiranë, Bashkia Kukës, etj).

⁷⁰ Ndër argumentat e paraqitura përmendim: Listat janë gati por nuk jepet asnjë argument për mospublikimin e tyre; Listat janë në proces verifikimi por sipas tyre ka kohë deri në 2 muaj para ditës së zgjedhjeve për të bërë publikimin e tyre; Listat janë online dhe skanë marrë udhëzim apo urdhër që t'i publikojnë, etj. Këto dhe argumente të tjera janë dhënë nga njësitë vendore si në Bulqizë, Durrës, Librazhd, Tepelenë, Njësia Bashkiake Nr. 8 – Tiranë, Sarandë, Malësi e Madhe, etj.

e qendrave të votimit me më pak se 200 zgjedhës si dhe ndarjen e qendrave të votimit me më shumë se 1000 zgjedhës (përjashtoj qarkun Tiranë ku ky kufi është 700 zgjedhës), ndërkohë që afati i përcaktimit të vendndodhjes së qendrave të votimit sipas procedurave të parashikuara në Kodin Zgjedhor dhe në udhëzimin e Ministrisë së Brendshme ka qenë data 3 Janar 2013⁷¹.

Koalicioni i tërheq vëmendjen Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile pranë Ministrisë së Brendshme, për një përkushtim dhe profesionalizëm sa më të lartë në përmbushje të detyrimeve ligjore.

Sipas informacioneve të marra kryesisht nga Njësitë Bashkiake në Tiranë, konstatohet se ka patur probleme në lidhje me ndarjen e zgjedhësve me të njëjtin mbiemër apo nga e njëjta familje në qendra të ndryshme votimi, ndërkohë që Kodi Zgjedhor përcakton qartë se “*programi kompjuterik i RKGJC (Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile) bën ndarjen automatike të listës mbi bazën e numrit të qendrës së votimit të caktuar çdo zgjedhësi. Zgjedhësit me të njëjtin mbiemër nuk mund të ndahen në lista të ndryshme*”⁷².

Në ekstratin zgjedhor janë evidentuar edhe pasaktësi të tjera, madje rezultojnë qendra votimi pa asnjë të dhënë siç është rasti i QV Nr. 1699 në Njësinë Bashkiake Nr. 1, në Tiranë⁷³.

Koalicioni i tërheq vëmendjen Ministrisë së Brendshme që të detyrojë institucionet dhe administratën në varësi të zbatojnë ligjin me seriozitet dhe profesionalizëm, si dhe t’u ofrojë informacion dhe gatishmëri për bashkëpunim të gjithë aktorëve institucionalë sikundër e kërkon ligji.

Ministria e Brendshme duhet të marrë urgjentisht masa të furnizojë me pajisjet e nevojshme kancelarike Zyrat e Gjendjes Civile në Kuçovë, Lushnjë, Kavajë, etj, ku procesi i publikimit të listave ka ngecur për mungesë të bojës së printerit.

Në përfundim, Koalicioni i kërkon Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve që të përdorë sa më parë instrumentat e tij për të mbikëqyrur nga afër procesin e hartimit të listave të zgjedhësve, administrimin e zonave të qendrave të votimit si dhe të numrit të zgjedhësve për çdo qendër votimi, sikundër e kërkon ligji⁷⁴, si edhe për të ushtruar autoritetin e tij për të mbështetur e ndihmuar Njësitë e Qeverisjes Vendorë në realizimin e këtij procesi shumë të rëndësishëm për zgjedhjet e ardhshme të 23 Qershorit 2013!

Tiranë, më 9 Janar 2013!

⁷¹ Neni 62, pika 5 e Ligjit Nr. 10 019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar me Ligjin Nr. 74/2012 datë 19.07.2012, si edhe Udhëzimi Nr. 374, datë 10.12.2012 “Për procedurat e hartimit të listave të zgjedhësve për zgjedhjet për Kuvendin”.

Ky proces është konstatuar në Elbasan, Vlorë, Përmet, Gjirokastrë, Pogradec, Shkodër, etj.

⁷² Neni 51, pika 3 e Ligjit Nr. 10 019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar me Ligjin Nr. 74/2012 datë 19.07.2012, si edhe Pika 8 e Udhëzimit Nr. 374, datë 10.12.2012 “Për procedurat e hartimit të listave të zgjedhësve për zgjedhjet për Kuvendin”.

⁷³ Sipas zyrtarëve të Njësive Bashkiake, Zyrtarët e RKGJC kanë pranuar gabimet në lista për shkak të një gabimi kompjuterik, madje kanë qenë këta të fundit që iu kanë kërkuar atyre të ndërpresin procesin e shpalljes së listave paraprake deri në saktësimin e tyre.

Koalicioni u përpoq të merrte reagim zyrtar nga RKGJC, por nuk iu dha asnjë shprehim nga zyrtarët përkatës.

⁷⁴ Neni 50, pika 3 e Ligjit Nr. 10 019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar me Ligjin Nr. 74/2012 datë 19.07.2012.

ANEKS V

LETËR E HAPUR

Drejtuar:

**Kryetares së Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve
Anëtarëve të Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve
Konferencës së Kryetarëve të Kuvendit të Shqipërisë**

Për dijeni:

*Kryetarëve të Partive Politike Parlamentare
Misionit të OSBE / ODIHR
Delegacionit të Bashkimit Europian
Zyrës së Këshillit të Europës
Ambasadës së Shteteve të Bashkuara
Opinionit Publik*

*E nderuar znj. Kryetare e Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve!
Të nderuar Anëtarë të Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve!
Të nderuar Anëtarë të Konferencës së Kryetarëve të Kuvendit të Shqipërisë!*

Koalicioni i Vëzhguesve Vendorë po ndjek me shumë vëmendje procesin e ndarjes së mandateve për çdo zonë zgjedhore për Zgjedhjet e Ardhshme Parlamentare të 23 Qershorit 2013.

Duke vlerësuar të drejtat e qytetarëve si të drejta themelore e të patjetërsueshme, mbi respektimin katërcipërisht të të cilave duhet të ngrihet dhe të funksionojë shteti ligjor dhe i së drejtës, Koalicioni vëren se procesi i ndarjes së mandateve për çdo zonë zgjedhore nuk po respekton të drejtën kushtetuese të barazisë së votës së qytetarëve⁷⁵.

Një ndarje mandatesh pa respektuar procedurat dhe kompetencat e përcaktuar qartazi në Kodin Zgjedhor, do të sillte si pasojë pesha elektorale të diferencuara të votave të qytetarëve nëpër qarqe, duke prodhuar një proces zgjedhor të vesuar (të metë) edhe sikur të gjitha standartet e tjera të plotësoheshin pa asnjë lloj vërejtje.

Duke analizuar procesin e deritanishëm, Koalicioni vëren se:

Në zbatim të Kodit Zgjedhor, Ministria e Brendshme i dërgoi KQZ-së më datën 9 Nëntor 2012 të dhënat mbi numrin e përgjithshëm të popullsisë. KQZ mori në shqyrtim çështjen e ndarjes së mandateve të zonave zgjedhore më datën 21 Nëntor 2012.

Nënkryetari dhe dy anëtarë të KQZ-së të propozuar nga opozita kërkuan të kenë informacione shtesë në lidhje me lëvizjet e popullsisë në qarkun e Kukësit, duke bërë që shqyrtimi i çështjes të shtyhet.

⁷⁵ Neni 45, Pika 4 e Kushtetutës së Shqipërisë: “4. Vota është vetjake, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë.”

Çështja u rimorr në diskutim në mbledhjen e datës 23 Nëntor, por duke qenë se përgjigja nga Ministria e Brendshme nuk jepte të dhëna mbi informacionin e kërkuar, pasi i konsideronte ato të dhëna personale, tre komisionerët këmbëngulën për mosshqyrtimin e çështjes deri më marrjen e informacionit të kërkuar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i gjendur në këtë situatë, vendosi të mos caktojë numrin e mandateve për çdo zonë zgjedhore, për zgjedhjet për Kuvendin 2013⁷⁶. Duke qenë se dita e zgjedhjeve ende nuk ishte dekretuar, afati ligjor për të ankimuar vendimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës së Apelit ishte 30 ditë, pra deri më datën 24 Dhjetor 2012, por asnjë subjekt i interesuar nuk e ndërmorri këtë hap.

Më datën 11 Janar 2013, Sekretarja e Përgjithshme e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me shkresën Nr.Prot. 174 “*Informacion në lidhje me zbatimin e dispozitave të Kodit Zgjedhor për caktimin e mandateve për çdo zonë zgjedhore të Zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë të vitit 2013*”, i drejtohet Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit të Shqipërisë, ku në paragrafin e parafundit i kërkon Kuvendit të investohet për përmbylljen e procedurave në lidhje me caktimin e mandateve të zonave zgjedhore⁷⁷.

Në lidhje me këtë proces **Koalicioni konstaton se:**

Neni 76 në pikën dy dhe tre⁷⁸ dhe Neni 24 pika 1 gërma “ë”, përcaktojnë dy momente procedurale: përcaktimin e mandave për çdo zonë si edhe miratimin e mandave të çdo zone.

Tagri për hapin e parë i takon ekskluzivisht, sipas neneve të sipërpërmendura, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe kërkon shumicë të cilësuar për miratim prej jo më pak se 5 votash pro të anëtarëve të KQZ-së. Kur ky hap është hedhur, investohet Kuvendi, i cili e miraton mbi bazën e materialit që i dërgohet prej KQZ-së.

Kodi Zgjedhor parashikon në pikën 2 të Nenit 76 se KQZ duhet të bëjë llogaritjen dhe përcaktimin e mandateve jo më vonë se 15 ditë nga marrja e të dhënave. Duke qenë se të dhënat në KQZ janë dorëzuar më 9 Nëntor 2012, afati është ezauruar më datën 24 Nëntor 2012, madje deri më sot, në këtë pikë, **KQZ është treguar e pazonja për realizmin e afateve të Kodit Zgjedhor ndaj procesi nuk mund të vazhdojë më tej.**

⁷⁶Pika 1 e Vendimit Nr.15, datë 23.11.2012 “*Për caktimin e numrit të mandateve për çdo zonë zgjedhore të zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë të vitit 2013*”: “1. Të mos caktojë numrin e mandateve për çdo zonë zgjedhore, për zgjedhjet për Kuvendin 2013”.

⁷⁷ Paragrafi i parafundit, shkresa Nr.Prot. 174, datë 11.01.2013: “Nisur nga fakti se për zgjedhjet për Kuvendin 2013 KQZ nuk miratoi caktimin e numrit të ri të mandateve për çdo zonë zgjedhore, në përputhje me nenin 76 të Kodit Zgjedhor ju përcjellim këtë informacion mbi procedurat e ndjekura në zbatim të këtij Kodi, me qëllim informimin e Kuvendit dhe përmbylljen prej tij të procedurave të parashikuara nga ky Kod në lidhje me këtë çështje”.

⁷⁸ Neni 76, pika 2 dhe 3 e Ligjit Nr. 10 019, datë 29.12.2008 “*Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar me Ligjin Nr. 74/2012 datë 19.07.2012: “*Procedura dhe periudha e përcaktimit të mandateve*” “2. Jo më vonë se 15 ditë nga marrja e të dhënave, KQZ-ja kryen llogaritjen për caktimin e mandateve për çdo zonë zgjedhore, sipas kritereve dhe procedurave të përcaktuara në nenin 75 të këtij Kodi dhe ia dërgon menjëherë Kuvendit. Kuvendi, me procedurë të përshpejtuar, miraton me vendim ndarjen e mandateve.

3. Në çdo rast numri i mandateve për çdo zonë zgjedhore miratohet jo më vonë se 6 muaj përpara fundit të mandatit të Kuvendit. Numri i mandateve për çdo zonë zgjedhore nuk rishikohet në rast të zgjedhjeve të parakohshme”

Por, Kodi Zgjedhor lë një shteg sigurie në rastin eventual. Ndonëse në pikën dy të Nenit 76 kërkon një procedurë të përshpejtuar të Kuvendit për miratim, në pikën tre të po këtij neni Kodi Zgjedhor përcakton se **për çdo rast afati maksimal i përcaktuar për miratimin e mandateve është deri në 6 muaj para fundit të mandatit të Kuvendit, pra deri më datën 7 Mars 2013.**

Në këtë pikë shihet një indulgjencë e vetë Kodit Zgjedhor përse i përket afateve, duke qenë se i jep kohë Kuvendit për finalizimin e procesit, rrjedhimisht i jep kohë edhe hallkave të mëparshme siç është Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve, të ezaurojnë kompetencën dhe detyrimin e tyre, pavarësisht afateve të kaluara e të shkelura tashmë.

KQZ si një organ kolegjal, në kushtet e mospërmbushjes së detyrimeve ligjore dhe detyrimit madhor kushtetues për caktimin e mandateve, i ka të gjitha tagrat për të marrë në shqyrtim sërish çështjen e përcaktimit të mandateve, madje duke ribërë ndarjen e mandateve mbi bazën e numrit të popullsisë në periudhën e tanishme.

Kjo do të maksimizonte akoma më shumë përmbushjen e detyrimit kushtetues mbi barazinë e votës, pasi në përlllogaritjet e tanishme të ndarjes së mandateve do të reflektoheshin edhe lëvizjet e mundshme të popullsisë që mund të jenë bërë pas datës 7 Nëntor e deri në periudhën kur do të merret në rishqyrtim çështja.

Rimarrja në shqyrtim e çështjes së ndarjes së mandateve prej KQZ-së, nxitet akoma më shumë nga Koalicioni, duke pasur parasysh mosqënien aspak korrekt me ligjin të vendimit Nr. 15 datë 23 Nëntor 2012 “Për caktimin e numrit të mandateve për çdo zonë zgjedhore të zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë të vitit 2013”, ku KQZ vendosi për të mos caktuar ndarjen e mandateve për Zgjedhjet Parlamentare të 23 Qershorit 2013.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, për një detyrë absolute që ia ngarkon Kodi Zgjedhor përkatësisht në Nenin 76 dhe Nenin 24, nuk mundet në asnjë rast të heq dorë.

Vendimmarrja në një mbledhje për çështje që kërkojnë shumicë të cilësuar prej jo më pak se 5 vota, nuk mund të rezultojë me vendim me katër vota, pasi në kuptim të nenit 22 pika 5, këto mbledhje as nuk mund të zhvillohen nëse nuk marrin pjesë së paku 5 anëtarë, dhe sigurisht që vendimi kërkon së paku 5 vota pro.

Për më tepër, argumenti i përdorur, se merret ky vendim pasi nuk arrihet shumicë e cilësuar votimi prej së paku 5 votash pro, **është i pavend dhe kundër frymës së Kodit Zgjedhor dhe funksionimit të KQZ-së si një institucion kolegjal dhe i pavarur.**

Si i tillë, ky vendim jo vetëm që nuk ka asnjë pasojë faktike në lidhje me përgatitjen e procesit zgjedhor, por as nuk mund të përdoret si vendimmarrje e parë për tu ndjekur nga vendimmarrja në vazhdimësi procedurale, e Kuvendit të Shqipërisë, sikundër është kërkuar zyrtarisht nga Sekretarja e Përgjithshme e KQZ-së.

Koalicioni deklaroi se në mënyrë kategorike Sekretarja e Përgjithshme e Administratës së KQZ-së, nuk ka tagër që të investojë Kuvendin, sepse bazuar në Nenin 20 pika 1 gërma “a” të Kodit Zgjedhor, është Kryetari ai që e përfaqëson KQZ-në në marrëdhënie me institucionet e tjera. Sekretarja e Përgjithshme i ka të përcaktuara qartë detyrat dhe kompetencat e saj në Nenin 25 të kodi Zgjedhor e veçanërisht në pikën 4 të tij.

Kjo situatë sjell edhe njëherë në vëmendje miratimin me urgjencë të rregullore “Për Organizimin dhe funksionimin e KQZ-së”, e cila duhet të ishte miratuar që më datën 26 Dhjetor 2012, pasi KQZ nuk mund të administrojë procesin në mënyrë korrekte pa një rregullore në fuqi.

Madje, edhe nëse do të pranohej në fuqi rregullorja “Për Organizimin dhe funksionimin e KQZ-së” e miratuar me Vendimin nr. 26, datë 3 Mars 2005, sikundër pretendohet dhe merret e mirëqenë prej KQZ-së⁷⁹, Sekretari i Përgjithshëm edhe në këtë rregullorë në asnjë moment nuk shihet si aktor ndaj të tretëve. Ata që mund të komunikojnë në emër të KQZ-së janë vetëm Kryetari, Nënkrjetari dhe Anëtarët⁸⁰ e Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve.

Kuvendi nuk mund të investohet jo vetëm në saj të delegjimitetit të shkresës së përcjellë nga Sekretarja e Përgjithshme e KQZ-së, por edhe për përmbajtjen e kësaj shkrese, ku i ofrohet Kuvendit për të parë, dhe në logjikën procedurale për të miratuar⁸¹, vendimin e KQZ-së të datës 12.02.2009 “Për caktimin e numrit të mandateve për çdo zonë zgjedhore të zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë të vitit 2009”.

Neni 76 pika 3 e Kodit Zgjedhor nuk lë asnjë hapësirë diskutimi për këtë pikë, pasi përcakton prerë se vetëm në rast të zgjedhjeve të parakohshme nuk bëhet rishikim i numrit të mandateve, çka nënkupton se për Zgjedhjet Parlamentare të 2013 nuk mund të përdoret ndarja e mandateve për zonat zgjedhore e Zgjedhjeve Parlamentare të 2009, por duhet një ndarje e re.

Mbi të gjitha, mosndarja e re e mandateve për zgjedhjet e ardhshme, përbën një shkelje të mirëfilltë kushtetuese përsa i përket barazisë së votës së qytetarëve.

Në konkludim për sa më sipër, Koalicioni i Vëzhguesve Vendorë i kërkon Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve që të marrë në shqyrtim sërish çështjen e përcaktimit të mandateve, madje duke ribërë ndarjen e mandateve mbi bazën e numrit të popullsisë në periudhën e tanishme.

Koalicioni i bën thirrje Kryetarëve të Partive Politike Parlamentare si dhe Konferencës së Kryetarëve të Kuvendit të Shqipërisë që të tregojnë vullnetin e përbashkët në funksion të zbatimit me korrektësi të Kushtetutës dhe Ligjit duke mbështetur dhe nxitur anëtarët e KQZ-së në zhvillimin e përgjegjësive të tyre në lidhje me ndarjen e mandateve të zonave zgjedhore për zgjedhjet e ardhshme.

Gjithashtu, Koalicioni sërish tërheq vëmendjen për të miratuar në mënyrë urgjente Rregulloren e Organizimit dhe të Funksionimit të KQZ-së, në mënyrë që t’i paraprihet jo vetëm problematikave të mundshme në të ardhmen, por për të rritur sa më shume

⁷⁹Në një komunikim të brendshëm brenda institucionit të KQZ-së, sipas shkresës Nr.Prot. 934/1, datë 26.12.2012, Sekretarja e Përgjithshme i përgjigjet një anëtarit të KQZ-së duke iu referuar rregullore së miratuar në vitin 2005, si rregullore në fuqi. Pavarësisht se kjo rregullore që në hyrje të saj, por edhe në përmbajtje të neneve, i referohet Kodit Zgjedhor të vitit 2003 dhe neneve përkatëse, të cilat tashmë janë të shfuqizuara.

⁸⁰ Neni 58 i Vendimit Nr. 26, datë 03.03.2005 “Për miratimin e Rregullore “Për organizimin dhe funksionimin e KQZ-së””: “Në çdo rast, dokumentet që dalin nga KQZ-ja dhe ju drejtohen të tretëve kanë nënshkrimin e Kryetarit. Në mungesë të kryetarit ato nënshkruhen prej zëvendëskryetarit dhe në raste të caktuara, me autorizim të kryetarit, nga një anëtar tjetër i KQZ-së.”

⁸¹ Paragrafi i fundit, shkresa Nr.Prot. 174, datë 11.01.2013: “Bashkëlidhur po ju përcjellim vendimin e KQZ-së Nr. 2, datë 12.02.2009 “Për caktimin e numrit të mandave për çdo zonë zgjedhore të zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë të vitit 2009””.

efektshmërinë dhe rendimentin e funksionimit dhe të punës së Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve.

Për Koalicionin e Vëzhguesve Vendorë

Përfaqësuesit e organizatave Drejtuese

Gerta META
Drejtore Ekzekutive

Premto GOGO
Kryetar

Rajmonda PRIFTI
Drejtore Ekzekutive

**Shoqata për Kulturë
Demokratike**

KRIIK Albania

**Shoqata për Gratë
dhe Fëmijët**

Tiranë, më 19 Janar 2013!

ANEKS VI**DEKLARATË****Listat paraprake të zgjedhësve,
mundësi të kufizuara për informimin e votuesve**

Procesi i saktësimit dhe miratimit të Listave të Zgjedhësve ka qenë një ndër elementët më shumë të kontestuar nga subjektet elektorale në proceset e mëparshme zgjedhore. Madje, edhe pas informatizimit dhe kthimit të këtij procesi në një proces thellësisht teknik, nuk kanë munguar kritikrat jo vetëm nga subjektet elektorale por edhe nga vëzhguesit e procesit.

Kodi Zgjedhor i tanishëm materializon rëndësinë e procesit të saktësimit të listave të zgjedhësve të ndërthurur me procesin e përcaktimit të qendrave të votimit, si një detyrim i drejtëpërdrejtë ndaj të drejtës së pamohueshme të qytetarit për të votuar.

Detyrimet e parashikuara në Kod, të plotësuara në mënyrë më specifike nga udhëzimi Nr. 374 i Ministrisë së Brendshme, datë 10.12.2012 “Për procedurat e hartimit të listave të zgjedhësve për zgjedhjet për Kuvendin” si dhe nga Udhëzimi Nr. 1 i Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve, datë 12.12.2012 i KQZ-së “Për mënyrën e ngritjes dhe caktimit të vendndodhjes së qendrave të votimit dhe përgatitjen e hartës së njësisë së qeverisjes vendore për zgjedhjet”, përcaktojnë qartë dhe në mënyrë të detajuar edhe mënyrat e përfshirjes së qytetarit në këtë proces verifikimi dhe saktësimi.

Konkretisht, në zbatim të këtyre dispozitave, në rend kronologjik parashikohet se:

- Jo më vonë se data 8 Dhjetor 2012 nis procesi i hartimit të ekstratit të përbërësve zgjedhorë.

- Jo më vonë se data 18 Dhjetor 2012, Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile gjeneron formatin elektronik të ekstraktit të përbërësve zgjedhorë, të ndarë sipas qendrave të votimit të zgjedhjeve të datës 8 Maj 2011 për çdo bashki/njësi bashkiake/komunë.

Nëpunësi i zyrës së gjendjes civile, pranë çdo njësie vendore, duke u bazuar në listën e gjeneruar, kontrollon për numrin e zgjedhësve për çdo qendër votimi.

Ky kontroll i raportit ditor bëhet çdo ditë përgjatë gjithë periudhës së rishikimit të listës deri më datën 13 Maj 2013, pasi mund të ketë shtesa apo pastrime nga lista e votuesve.

Kur vëren në raportin ditor se ka qendra votimi me më pak se 200 zgjedhës apo qendra votimi me më shumë se 1000 zgjedhës (700 zgjedhës për QV-të në qarkun Tiranë) njofton, brenda 48 orëve, kryetarin e bashkisë/njësisë bashkiake/komunës.

- Kryetari i bashkisë/komunës/njësisë bashkiake, i cili ka marrë njoftimin nga përgjegjësi i zyrës së gjendjes civile, vendos bashkimin dhe/ose ndarjen e qendrave të votimit sipas kërkesave të kriterit numerik [(jo QV me më pak se 200 zgjedhës, dhe jo QV me më shumë se 1000 zgjedhës (700 zgjedhës për QV-të e Qarkut Tiranë)] dhe cakton vendndodhjen e saktë, adresën e plotë të qendrave të votimit.

- Jo më vonë se 5 ditë nga marrja e informacionit nga zyra e gjendjes civile, vendimet e kryetarit për ndarjen ose bashkimin e qendrave të votimit, si dhe ndryshimet e adresave të qendrave të votimit, nëse ka të tilla, i dërgohen në

formë shkresore zyrës së gjendjes civile për zbatim dhe për dijeni Ministrisë së Brendshme, Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile si dhe prefektit të qarkut.

- Jo më vonë se data 3 Janar 2013, kryetari i njësisë së qeverisjes vendore, me vendim, cakton vendndodhjen e qendrës së votimit, në mjedise publike.

Në rast të pamundësisë objektive për të caktuar QV në mjedise publike, Kryetarët e Njësisë Vendore, jo më vonë se data 8 Janar 2013 i paraqesin KQZ-së kërkesë për të miratuar QV-në në mjedisë private, sipas kriterëve të përcaktuara.

- KQZ-ja miraton me vendim vendndodhjen e QV-ve në ambiente private jo më vonë se data 3 Shkurt 2013.

Pas datës 3 Shkurt, për ndryshimet e mundshme të Vendodhjes së Qendrave të Votimit, si pasojë e tejkalimit të numrit maksimal apo e zvogëlimit të numrit minimal të numri të zgjedhësve që duhet të ketë një qendër votimi, Kryetari i Njësisë Vendore, brenda 10 ditësh nga shpallja e ekstratit zgjedhor të rradhës e dërgon në KQZ apo në KZAZ (nëse ato janë ngritur).

Por në asnjë rast nuk lejohet ndërrimi i vendndodhjes së QV-ve, 40 ditë përpara ditës së Votimit.

- Ndërkohë, zyrat e gjendjes civile në bashki/komuna/njësi bashkiake, brenda datës 3 janar 2013, printojnë dhe publikojnë, pasi të firmoset nga kryetari përkatës, ekstraktin e parë të përbërësve zgjedhorë të të gjithë zgjedhësve, sipas vendbanimit dhe qendrave të votimit, nën juridiksionin e tyre territorial.

Publikimi bëhet në ambientet e zyrave të gjendjes civile ose në ambientet pranë tyre me akses të lirë për publikun.

- Ekstrakti i përbërësve zgjedhorë, me të njëjtat kriterë, printohet dhe publikohet edhe çdo 30 ditë sipas përcaktimit të Kodit Zgjedhor, pra në datën 3 mars, 3 prill dhe 3 maj 2013. Në çdo publikim përfshihen ndryshimet dhe saktësimet e bëra përgjatë periudhës 30 ditore pararendëse që nga publikimi i mëparshëm.

- Brenda datës 3 Mars 2013, kryetari i bashkisë/komunës/njësisë bashkiake, bën njoftimin me shkrim të zgjedhësve, të përfshirë në ekstraktin e printuar sipas qendrave të votimit brenda territorit të bashkisë/komunës/njësisë bashkiake përkatëse.

Njoftimi për shtetasit është sipas “modelit nr. 1”. RKGJC bën të mundur që formati i këtij njoftimi të gjenerohet nga sistemi.

Kryetari i Njësisë Vendore po deri më datën 3 Mars njofton edhe shtetasit me moshë mbi 100 vjeç për arsyen e mospërfshirjes së tyre në listë. Njoftimi është sipas modelit nr. 2 që i është bashkangjitur Udhëzimit të Ministrisë së Brendshme drejtuar Njësisë Vendore.

Zgjedhësit, të cilët kanë marrë njoftimin me shkrim nga ana e bashkisë/njësisë bashkiake/komunës dhe konstatojnë se në përbërësit e tyre zgjedhorë ka mospërputhje, i drejtohen zyrës së gjendjes civile përkatëse për të bërë rregullimet e mundshme.

Të drejtën për kërkesë e kanë dhe shtetasit që kanë mbushur moshën 100 vjeç.

Krahas ndryshimit të përbërësve zgjedhorë në rrugë administrative, zyra e gjendjes civile do të pasqyrojë edhe rastet e vendimeve të gjykatës, deri në ditën e printimit të listës së zgjedhësve

Çdo zyrë e gjendjes civile në bashki/njësi bashkiake/komuna, më datë 13 Maj 2013 printon nga RKGJC-ja dhe firmos listën e zgjedhësve për çdo qendër votimi, duke përfshirë edhe institucionet e posaçme, nën juridiksionin territorial të saj dhe ia dorëzon kryetarit.

Kryetari miraton dhe firmos listën dhe e dërgon brenda datës 18 Maj 2013, në të tria formatet e parashikuara në Kodin Zgjedhor, në Komisionet Zonale të Administrimit Zgjedhor përkatëse.

Sikundër konstatohet lehtë, procesi i hartimit dhe i saktësimit të listave është një proces thellësisht teknik.

KVV më datën 9 Janar është shprehur publikisht për moszbatimin e afateve të deriatëhershme të këtij procesi dhe mos publikimin e listave në një masë të konsiderueshme të Njësive Vendore.

Edhe në këtë afat të dytë të publikimit të ekstratit të dytë të përbërësve zgjedhore, Koalicioni vëren me shqetësim se ende një pjesë e konsiderueshme e **Drejtuësve të Institucioneve Vendore dhe atyre Qëndrore të përfshira në këtë proces, trajtojnë me një mungesë të lartë përgjegjshmërie afatet ligjore të parashikuara**, pavarësisht arsyeve teknike (objektive ose jo) që ata parashitrojnë.

Pavarësisht se në një pjesë të madhe të njësive vendore është bërë publikimi i listave⁸² si dhe përcaktimi dhe dërgimi i vendndodhjes së qendrave të votimit, ende ka Njësi të Qeverisjes Vendore ku listat nuk janë publikuar fare⁸³, Njësi të Qeverisjes Vendore ku janë publikuar me vonesë listat e ekstratit të parë, por akoma nuk janë publikuar listat e korrigjuara të ekstratit të dytë të 3 shkurtit⁸⁴, apo Njësi të Qeverisjes Vendore ku ende nuk është bërë përcaktimi i QV-ve dhe dërgimi i tyre Komisionit Qendror të Zgjedhjeve⁸⁵.

Koalicioni konsideron si jo korrekt dhe aspak efikas publikimin e listave pranë Qendrave të mëparshme të Votimit, kur dihet se këto QV janë në institucione publike (si kopshte, çerdhe, shkolla, etj) të cilët funksionojnë me orar të kufizuar dhe jo me hyrje të lirë për publikun e gjerë.

Kjo mënyrë publikimi, pavarësisht argumentit të mungesës së hapësirave të publikimit, është në shkelje të dispozitave të Kodit Zgjedhor (neni 51, pika 4) dhe të Udhëzimit të Ministrisë të Brendshme, si edhe nuk garanton aspak dispozitën për publikimin në ambiente me hyrje të lirë për publikun.

Gjithashtu, kjo mënyrë publikimi nuk është aspak komode edhe për qytetarin, i cili në rast të mosgjatjes së emrit të tij në listën e QV së mëparshme, i duhet të shkojë e të verifikojë me rradhë qendrat e tjera të votimit.

Koalicioni e konsideron aspak serioze situatën kur ky proces i rëndësishëm të vazhdojë të pengohet për shkak të mungesave të bazës materiale si letra apo boja e printerit, sikundër po ndodh në mjaft Njësi të Qeverisjes Vendore, përfshi këtu edhe njësitë bashkiake në qytetin e Tiranës⁸⁶. Madje, Koalicioni përgëzon ata drejtues të Njësive Vendore të cilët kanë arritur t'i kalojnë këto vështirësi me zgjidhje alternative.

Koalicioni shprehet mjaft i shqetësuar për të gjithë ecurinë e deritanishme të këtij procesi, e cila ndër të tjera **rrezikon zbatimin e mundësisë së vetme të detyrimit**

⁸² Si në Berat, Peshkopi, Gramsh, Tepelenë, Kukës, Pukë, Nj. B. Nr. 10 Tiranë, Sarandë, etj.

⁸³ Në qytetet Elbasan, Gjirokastrë, Kavajë, Nj. B. Nr. 2 Tiranë, listat ende nuk janë publikuar. Në Shkodër, prej njësisë vendore thuhet se listat janë publikuar nëpër qendrat e votimit, por nuk gjenden të shpallura ende në këto të fundit. Në Vlorë listat janë saktësuar dhe shpallur pjesërisht.

⁸⁴ Në qytetin e Bajram Currit, Korçës, Nj.B. Nr. 6, 8, 9 dhe 11 Tiranë, Përmet, etj.

⁸⁵ Si në Durrës, Librazhd, Fier, Bilisht, etj.

⁸⁶ Njësitë Bashkiake N.1, N.5, N.7, N.8, N.10 të qytetit të Tiranës, bashkia Përmet janë në pamundësi totale të bazës teknike për të kryer printimin e listave të zgjedhësve për shpalljen e tyre, aq më tepër për t'ia disponuar subjekteve zgjedhore.

ligjor që kanë Njësitë e Qeverisjes Vendore për të njoftuar me shkrim çdo zgjedhës të përfshirë në listat paraprake të qendrave të votimit në territorin e tyre.

Mbi bazën e këtij lajmërimi me shkrim, që përmban numrin e qendrës së votimit, vendndodhjen dhe adresën e saj, si dhe numrin rendor të zgjedhësit në listën e zgjedhësve të qendrës së tij të votimit, çdo qytetari i jepet mundësia të kontrollojë dhe saktësojë të dhënat e tij në listën e votuesve.

Ky proces, në detyrim të Nenit 52 të Kodit Zgjedhor, duhet të kryhet brenda datës 3 Mars 2013.

Kodi Zgjedhor në nenin 52 pika 4, parashikon që Kryetarët e Njësite të Qeverisjes Vendore duhet të raportojnë për përmbushjen e këtij detyrimi, sipas Udhëzimit të Ministrisë të Brendshme, **ndërkohë që në Udhëzimin Nr. 374 datë 10.12.2012 “Për procedurat e hartimit të listave të zgjedhësve për zgjedhjet për Kuvendin”, nuk ka asnjë parashikim për mënyrat e raportimit apo të verifikimit nëse është përmbushur apo jo një detyrim i tillë ligjor.**

Për më tepër, nga monitorimet e bëra edhe në ato njësi të cilat i kanë shpallur listat, procesi i njoftimit të qytetarëve nuk ka filluar, pasi **Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile ende nuk e ka gjeneruar pranë Njësite të Qeverisjes Vendore “Modelin nr. 1”, të përcaktuar me udhëzim për njoftimin e qytetarëve.**

Njëkohësisht, **Ministria e Brendshme akoma nuk u ka kaluar Njësite të Qeverisjes Vendore fondin përkatës për mbulimin e shpenzimeve për njoftimin, sikundër parashikohet në nenin 52, pika 5 të Kodit Zgjedhor.**

Koalicioni sërish i kërkon Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve të ndjekë nga afër procesin e përgatitjes së listave, dhe në zbatim të Udhëzimit nr. 1 datë 12.12.2012 të KQZ-së, të marrë masat e nevojshme për të gjithë ata Kryetarë të Njësite të Qeverisjes Vendore, që nuk kanë respektuar kriteret e kërkuara brenda datës 23 Janar 2013.

Ministria e Brendshme duhet në mënyrë urgjente të lëvrojë fonde për bazën materiale të nevojshme, si dhe për mbulimin e shpenzimeve të njoftimit të qytetarëve në lidhje me listat e zgjedhësve.

Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile duhet urgjentisht të gjenerojë pranë çdo njësie të pushtetit vendor “modelin Nr. 1” për njoftimin e qytetarëve.

Gjithashtu, RKGJC duhet të sa më parë të gjenerojë të dhënat në lidhje me qendra votimi të veçanta (si në Njësinë Bashkiake Nr. 5, Tiranë).

Kryetarët e Njësite të Qeverisjes Vendore duhet sa më parë të përfundojnë procesin e përcaktimit të Qendrave të Votimit dhe të shpalljes së Listave të Zgjedhësve, si edhe të bëjnë shpalljen e tyre në ambiente të lira për publikun pranë zyrave të gjendjes civile.

Gjithashtu, Kryetarët e Njësite të Qeverisjes Vendore duhet të nisin sa më parë njoftimin e të gjithë zgjedhësve të njësite të tyre vendore për të dhënat e tyre në listat e zgjedhësve.

Tiranë, më 10 Shkurt 2013!

ANEKS VII**DEKLARATË****Mosnjoftimi i zgjedhësve, shkelje serioze e procesit të saktësimit të listave**

Koalicioni i Vëzhguesve Vendorë (KVV) përgëzon dhe mbështet fort Komisionin Qëndror të Zgjedhjeve në zbatimin me korrektësi dhe pa ekuivok të ligjit, nisur nga vendimi i datës 22 Shkurt për marrjen e masave administrative ndaj Kryetarëve të Njësisve të Qeverisjes Vendore të cilët nuk kanë zbatuar kriteret ligjore përse iu përket të dhënave në lidhje me qendrat e votimit dhe listën e zgjedhësve.

Marrja e masës administrative "dënim me gjobë" për 139 kryetarë të njësisve të Qeverisjes Vendore, nuk duhet parë si qëllim më vete dhe as si përmbushje e misionit të KQZ-së.

Ky qëndrim duhet të prevalojë në mënyrë të palëkundur në punën dhe misionin e KQZ-së për të ushtruar presionin e nevojshëm dhe për të marrë masat e duhura kundrejt të gjithë institucioneve apo strukturave të cilat dëmtojnë përgatitjen në kohë dhe sipas kriterëve të kërkuara të infrastrukturës zgjedhore, e veçanërisht aspektit të përgatitjes dhe publikimit të listave të zgjedhësve.

Koalicioni është shprehur publikisht më parë⁸⁷ në lidhje me procesin e përgatitjes dhe publikimit të ekstraktit të parë dhe të dytë të listës së zgjedhësve, ku ka vënë theksin ndër të tjera për përmbushjen e detyrimit ligjor të njoftimit të zgjedhësve brenda datës 3 mars 2013.

Me shumë shqetësim deri më sot konstatohet se asgjë nuk ka ndryshuar nga situata e paraqitur në deklaratën e datës 10 Shkurt 2013.

Nga kontaktet e marra me Njësitë e Qeverisjes Vendore dhe Ministrinë e Brendshme, vërehet se **po veprohet në mënyrë flagrante ndaj të vetmit detyrim ligjor që ka shteti shqiptar për të njoftuar me shkrim dhe me kundër-firmë çdo zgjedhës në territorin e Republikës së Shqipërisë, ku t'i bëjë me dije nëse është i përfshirë në listat e zgjedhësve, me çfarë numri rendor si dhe në cilën qendër votimi do të votojë.**

Ky proces nuk ka filluar jo vetëm në 139 Njësitë e Qeverisjes Vendore që kanë pasur apo kanë probleme me listat dhe vendndodhjet e qendrave të votimit të gjobitura nga KQZ-ja, por, **nuk ka filluar në asnjë Njësi të Qeverisjes Vendore në mbarë vendin. Kjo i faturohet Ministrisë së Brendshme pasi nuk ka lëvruar fondin përkatës për njoftimin e zgjedhësve dhe Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile nuk gjeneron pranë njësisve të pushtetit vendor "Modelin Nr. 1", të nevojshëm për tu përdorur për njoftimin e qytetarëve.**

Koalicioni e konsideron alarmante këtë situatë, pasi pas datës 3 Mars askush nuk detyrohet më nga ligji për të njoftuar qytetarët për qënien apo jo të tyre në listë.

Pas kësaj date mbetet vetëm përgjegjësi e qytetarëve për të verifikuar dhe saktësuar nëse ata do të figurojnë në listat finale të zgjedhësve.

⁸⁷ Deklarata e datës 9 Janar 2013 "Listat paraprake të zgjedhësve ende të pasakta e të papublikuara" (<http://www.zgjedhje.al/index.php?idart=36&gj=sh>), dhe deklarata e datës 10 Shkurt 2013 "Listat paraprake të zgjedhësve, mundësi të kufizuara për informimin e votuesve" (<http://www.zgjedhje.al/index.php?idart=38&gj=sh>)

Koalicioni i kërkon në mënyrë urgjente Ministrit të Brendshëm të ushtrojë autoritetin e tij në përmbushje të ligjit për të detyruar RKGJC të gjenerojë modelin e njoftimit pranë Njësive të Qeverisjes Vendore si dhe të lëvrojë sa më parë buxhetin përkatës.

Madje, Koalicioni e nxit Ministrin e Brendshëm të gjejë hapësirat që i siguron ligji për të bërë të mundur përmbushjen e procesit të njoftimit të qytetarëve, edhe pas kalimit të afatit ligjor të parashikuar.

Po ashtu, Ministria e Brendshme duhet urgjentisht të mbyllë procedurat e prokurimeve dhe të furnizojë me bazën e nevojshme materiale Zyrat e Gjendjes Civile pranë Njësive të Qeverisjes Vendore, në mënyrë që **të mos pengohet publikimi i ekstraktit të tretë të përbërësve zgjedhorë i parashikuar më datën 3 mars 2013.**

Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve duhet të ndjekë me më shumë vëmendje të gjithë procesin e përgatitjes së listave të zgjedhësve, madje duhet të ushtrojë presionin e nevojshëm dhe të kërkojë informacion nga të gjitha institucionet përkatëse jo vetëm mbi procesin e hartimit të tyre, por edhe mbi atë të shpalljes dhe njoftimit të qytetarëve si pjesë e procesit të verifikimit dhe saktësimit të të dhënave.

Gjithashtu, në lidhje me 34 Njësitë e Qeverisjes Vendore të cilat nuk kanë dhënë asnjë informacion pranë KQZ-së apo 57 të tjerat që e kanë sjellë këtë informacion me mangësi, **Koalicioni i kërkon KQZ-së të ushtrojë presion mbi to mbi afate të përcaktuara për t'i detyruar në zbatimin e ligjit, madje të ndërmarrë sërish masa të tjera më të forta sipas kompetencave që i lejon ligji.**

Tiranë, më 27 Shkurt 2013!

Kontakt:

i Koalicionit të Vëzhguesve Vendorë

Gerta Meta	(Shoqata për Kulturë Demokratike)	mob. 0692469393
Rajmonda Prifti	(Shoqata për Gratë dhe Fëmijët)	mob. 0682152667
Premto Gogo	(KRIIK Albania)	mob. 0682039297

Tel/fax: + 355 4 2245078;
E-mail: koalicioni2013@gmail.com;
Website: www.zgjedhje.al;